

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6021
E martë, 10 mars 2020
çmimi 0.40 €

Vasfije Krasniqi-Goodman, deputetëve: Krimet e luftës të merren me seriozitet

FAQE 7



PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, KA TAKUAR LIDERËT E PARTIVE POLITIKE NË LIDHJE ME KOORDINIMIN PËR ÇËSHTJE TË INTERESIT SHETËTOR F. 4-5

PRESIDENTI BËN PËRPPJEKJE TË KRIJOJË UNITET PËR DIALOGUN ME SERBINË



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar nga liderët politikë unitet për dialogun me Serbinë. Teksa të hënën i ka takuar liderët partiakë ndaras dhe i ka informuar ata për takimin me presidentin serb në

Shtëpinë e Bardhë, Thaçi ka kërkuar mbështetjen e tyre në këtë proces. Pasi ka përfunduar takimet me liderët e partive politike, presidenti Thaçi ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën ka thënë se vetëm të

bashkuar, Kosova mund të dalë fituese në këtë proces të dialogut me Serbinë. Në takimin e thirrur nga presidenti nuk ka shkuar vetëm lideri i Vetëvendosjes, njëherësh kryemnistër, Albin Kurti

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

POLITIKA E JASHTME E KOSOVËS: KURTI NJË HAP PARA, THAÇI NJË HAP PRAPA, SHBA-ja DHE BE-ja RIPOZICIONIM F. 11

Prof. Lisen BASHKURTI



AKTUALE

VELIU: POLICIA E KOSOVËS PARA VETES KA ENDE SFIDA TË MËDHA F. 6

MKRS E UP NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI F. 3

EKONOMI



KOSNETTI TAKOHET ME ABDIXHIKUN, MIRËPRET LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT F. 8

LIGJI I RI GJERMAN RREZIKON IKJEN E 'TRURIT' NGA KOSOVA F. 9

SPORT

FLAMURTARI NDALI BALLKANIN, TOVËRLANI DEBUTON ME FITORE F. 16

Dy raste me koronavirus në Shqipëri, merren masa në Kosovë



Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri ka konfirmuar dy rastet e para me koronavirus. Të infektuarit janë një burrë 54-vjeçar dhe djali i tij 28-vjeçar që kohën e fundit ishin kthyer nga Italia. Kryeministri Edi Rama ka bërë thirrje të mos bëhet panik dhe të ruhet qetësia. Ai ka thënë se të gjitha institucionet e arsimit do të mbyllën për dy

javë për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit. Ndërkaj Komiteti për Koordinimin dhe Vlerësimin e Situatës Epidemiologjike në Kosovë ka mbajtur takimin e rregullt, në të cilin ka shqyrtuar situatën epidemiologjike dhe përgatitjet që janë bërë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi edhe në Kosovë F. 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Asselborn: Dera e BE-së, e hapur për Ballkanin Perëndimor



SHKUP, 9 MARS - Dera e Bashkimit Evropian është e hapur dhe kjo është në interes jo vetëm të Maqedonisë së Veriut, por edhe të të gjitha vendeve të rajonit dhe të vetë BE-së, deklaroi të hënën ministri i Jashtëm i Luksemburgut, Jean Asselborn në një konferencë të përbashkët shtypi me homologun e tij maqedonas, Nikola Dimitrov në Shkup. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve në lidhje me qëndrimin rezervë drejt zgjerimit

edhe të vendeve të tjera anëtare të BE-së, përveç Francës, si Holanda dhe Danimarka, Asselborn theksoi se vlerëson se nëse Parisi ndryshon qëndrim, atëherë sipas gjitha gjasave edhe vendet e tjera duhet ta ndjekin atë shembull. “Komisioni Evropian dha raport pozitiv për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Nëse Franca merr qëndrim pozitiv, atë do ta ndjekin edhe vendet e tjera anëtare. Nëse nuk kemi sukses

tani, përveç se do të jetë e dëmshme për vendin tuaj, kjo do ta dëmtojë edhe politikën evropiane të Ballkanit”, vlerësoi Asselborn.

Shefi i diplomacisë së Luksemburgut e theksoi edhe nevojën nga përforsimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit. “Brukseli është më larg jush, por ju jeni këtu në një rajon të njëjtë dhe bashkëpunimi duhet të forcohet”, tha Asselborn.

Reformat në administratë, pjesë e fushatës parazgjedhore

Derisa lideri i LSDM-së, Zoran Zaev, është shprehur se do ta shkurtojë administratën për 20 për qind, nëse del partia e parë në zgjedhjet e 12 prillit, VMRO-DMPNE këtë qëndrim të tij e ka cilësuar dyfytërsi, pasi vetëm para dy-tre muajsh partia e Zaevit ka punësuar mijëra persona në administratë



Shkup, 9 mars - Administrata e Maqedonisë së Veriut, sipas njohësve, vazhdon të mbetet pre e politikës dhe presioni ndaj saj bëhet më i dukshëm gjatë proceseve zgjedhore. Këto komente vijnë si reagime ndaj deklarimit të liderit të Lidhjes Socialdemokrate, njëherësh ish-kryeministrit Zoran Zaev, i cili është shprehur se do ta shkurtojë administratën për 20 për qind nëse del partia e parë në zgjedhjet e 12 prillit. Por, partia opozitare maqedonase, VMRO-DMPNE, ka kritikuar këtë qëndrim të Zaevit, duke e cilësuar “dyfytërsi” pasi, siç janë shprehur nga kjo parti, vetëm para dy-tre muajsh partia e Zaevit që është në pushtet ka punësuar mijëra persona në administratë. Ndërkaq, partitë shqiptare elektoratit i kanë premtuar se do ta risin numrin e shqiptarëve në administratë.

Njohësit e çështjeve politike thonë se punëtorët e administratës mbahen peng gjatë proceseve zgjedhore, pasi

ata konsiderohen se mund të sjellin vota të sigurta. Bashkim Selmani, ligjërues në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se politika në Maqedoninë e Veriut ka dështuar ta reformojë administratën edhe pse kjo vërejtje është theksuar në të gjitha raportet e Komisionit Evropian. Selmani shton se partitë politike në Maqedoni të Veriut, gjatë fushatave zgjedhore, zotohen se do ta reformojnë administratën duke ulur numrin e të punësuarve, por sipas tij, asnjëra parti nuk ka guxim të bëjë spastrim të tillë në administratën shtetërore. “Administrata publike jo vetëm që është e mbingarkuar, por ajo që nga pavarësia e shtetit deri në ditët e sotme, paraqet një nga problemet bazë, mbingarkimi i saj, është sepse administrata shihet si formë punësimi për interesa partiake sesa si përkujdesje e partive politike që administrata e shtetit

të vihet në funksion të interesave të qytetarëve. Edhe deklarata e fundit e Zaevit mbi planet për ta shkurtuar administratën nuk besoj se do të ketë guxim ta bëjë këtë, por më tepër do të thosha se kjo deklaratë paraqet një konstatim të gjendjes reale me të cilën përballet aktualisht administrata në Maqedoninë e Veriut. Asnjëra nga partitë në vend nuk është marrë me cilësinë e funksionalitetin e administratorëve, që të jenë më efektiv në ofrimin e shërbimeve”, thotë Selmani.

Ndërkaq, Dragan Gocevski, ligjërues në Universitetin e

Shkupit, thotë se problemet tek administrata e shtetit, nuk është numri i madh i të punësuarve, por kualifikimi joadekuat i punonjësve, pasi sipas tij, punonjësit e administratës punësohen sipas çelësit partiak. Sipas Gocevskit, shqetësues mbetet fakti se shumica e punëtorëve të kualifikuar të administratës po largohen nga vendi. “Për mua, më shqetësues është fakti se nga administrata po largohen profesionistët sepse nuk arrijnë t'i bëjnë ballë presionit politik dhe si profesionistë me përvojë në lëmi të caktuar, ata lehtësisht gjinden

në sektorin real. Në administratën shtetërore mungojnë inxhinierët e teknologjisë informative, juristët, punonjësit në kulturë, etj. Pra, problemi qëndron në atë se kush do të mbetet të punojë në administratë dhe jo se sa punonjës numëron administrata dhe se a do të zvogëlohet numri i tyre”, thotë Gocevski.

Për vite të tëra, përfaqësuesit ndërkombëtarë kanë thënë se reformimi i administratës është çështje me prioritet për vendin. Administrata në Maqedoninë e Veriut numëron rreth 140 mijë punonjës.

Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria organizojnë Samitin e Procesit të Berlinit

SHKUP, 9 MARS - Është hera e parë që një shtet kandidat dhe një shtet anëtar i BE-së, si Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria të bashkë-organizojnë samitin e Procesit të Berlinit.

Aktivitetet e sivjetshme filluan në Shkup të dielën përmes paneleve të organizatave të

ndryshme joqeveritare nga rajoni, ndërsa do të përfundojnë me takimin e sotëm (e martë) të ministrave të jashtëm të rajonit dhe disa shteteve anëtare të BE-së. Në takimin e sotëm të nivelit të lartë pritet të diskutohet për dilemat rreth metodologjisë së re të zgjerimit të propozuar

nga Komisioni Evropian, për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor, të ardhmen e nismës “Mini-shengeni ballkanik”, fondet IPA 3, situatën me emigrantët, statusin e romëve, agjendën e gjelbër, etj. Nga takimi pritet të sillen plane konkrete dhe të realizueshme, të përgatiten doku-

mentet rreth kalimit të kufijve në shtetet e rajonit vetëm përmes letërnjoftimeve, heqjes së roamingut mes shteteve të rajonit si dhe uljen e çmimit të roamingut me shtetet anëtare të BE-së. Aktivitetet në Shkup i paraprijnë Samitit në Sofje që do të mbahet në vjeshtë.



Dy raste me koronavirus në Shqipëri, merren masa në Kosovë

Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri ka konfirmuar dy rastet e para me koronavirus. Të infektuarit janë një burrë 54-vjeçar dhe djali i tij 28-vjeçar që kohën e fundit ishin kthyer nga Italia. Kryeministri Edi Rama ka bërë thirrje të mos bëhet panik dhe të ruhet qetësia. Ai ka thënë se të gjitha institucionet e arsimit do të mbyllen për dy javë për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit. Ndërkaq Komiteti për Koordinimin dhe Vlerësimin e Situatës Epidemiologjike në Kosovë ka mbajtur takimin e rregullt, në të cilin ka shqyrtuar situatën epidemiologjike dhe përgatitjet që janë bërë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi edhe në Kosovë.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 MARS - Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri ka konfirmuar të hënën dy rastet e para në këtë vend, të personave të infektuar nga koronavirusi. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se pacientët janë babë e bir, të cilët kanë udhëtuar nga Firenze në Tiranë. "Dy qytetarët e konfirmuar me koronavirusin e ri, babë e bir, 54 vjeç dhe 28 vjeç, kanë qëndruar disa ditë në Firenze dhe kanë udhëtuar në rrugë tokësore nga Firenze drejt Tiranës, nëpërmjet pikës së Hanit të Hotit, me makinë personale. Menjëherë pas shfaqjes së shenjave klinike dhe lajmërimit të urgjencës

kombëtare në nr. 127 u janë marrë mostrat, të cilat u konfirmuan nga laboratorit i virologjisë në ISHP. Dy rastet e konfirmuara me COVID-19 janë në gjendje të stabilizuar dhe po trajtohen në Spitalin Infektiv. Ndërkohë, strukturat e shëndetit publik po realizojnë hetimin epidemiologjik dhe marrjen e mostrave të kontakteve", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Pas konfirmimit të këtyre dy rasteve, qeveria ka zhvilluar një mbledhje të jashtëzakonshme, ku kryeministri Edi Rama ka pohuar se në vazhden e masave u vendos që shkollat të mbyllen për dy javë. "Vetëpërmbahuni dhe ndërgjegjësohuni, armiku më i madh është paniku, jo

COVID-19. Nuk është murtaja e mesjetës. Nuk jemi përballë një diçkaje të panjohur. Të gjithë jemi të ekspozuar nga Covid-19, të punojmë së bashku, ta ruajmë njëri-tjetrin. Këshillat janë të thjeshta për t'u ndjekur, u rekomandohen të gjithë njerëzve në mbarë botën. Ndodhemi në një situatë që po kërcënohet e ardhmja e njerëzimit", ka thënë kryeministri Rama.

Ngritet gatishmëria kundër koronavirusit në Kosovë

Komiteti për Koordinimin dhe

Vlerësimin e situatës epidemiologjike lidhur me koronavirusin Covid-19 ka mbajtur të hënën takimin e rregullt në të cilin ka shqyrtuar situatën epidemiologjike në vend dhe përgatitjet që janë bërë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi edhe në Kosovë, marrë parasysh që tashmë raste me Covid-19 janë konfirmuar edhe në vendet fqinje me Kosovën.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, njëherësh kryesues i Komitetit për Koordinimin dhe Vlerësimin e Situatës, ka bërë me dije, në një konferencë për media, se Komiteti ka vendosur për ngritjen në nivel më të lartë të gatishmërisë lidhur me koronavirusin. "Kryeministrit të vendit do t'i prezantohet kërkesa e Komitetit që ta ngritë shkallën e gatishmërisë në nivel të Këshillit të Sigurisë së Kosovës", ka thënë ministri Vitia. Ai ka theksuar se duke pasuar parasysh faktin që deri më tash nuk ka raste të konfirmuara të koronavirusit, do të vazhdojnë përgatitjet për rastet eventuale. "Ne do t'i vazhdojmë përgatitjet për raste eventuale dhe hapat e tjerë do të jenë në raport me zhvillimet që do t'i kemi në terren", është shprehur ai.

Ministri Vitia ka theksuar se MSH-ja ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e planit të gatishmërisë dhe të reagimit kundër koronavirusit, ku ka bërë edhe përllogaritjen financiare të aktiviteteve që do të zhvillohen nga Ministria, IKShPK-ja, Klinika Infektive dhe institucionet e tjera mbështetëse. "Pra, secili hap i ardhshëm varet nga zhvillimet në terren", ka thënë ministri Vitia.

Deri sot në Kosovë janë testuar 57 raste për koronavirus, të gjitha kanë rezultuar negative. Gjatë ditës së hënë në IKShPK janë testuar pesë raste të dyshimta.

Në epiqendrën e virusit në Kinë është raportuar rënie e rasteve të reja me koronavirusin e ri. Sidoqoftë, shpërthimi i virusit nuk tregon shenja ndalese në Evropë. Në Itali numri i rasteve të prekura ka arritur në 7 375. Autoritetet italiane kanë vendosur 16 milionë njerëz në karantinë derisa po luftohet kundër shpërndarjes së koronavirusit. Numri i vdekjeve në Itali u rrit në 366 nga 233 sa ishin të shtunën. Numri i njerëzve të infektuar me koronavirusin SARS-CoV-2 arriti në 110 000 në të gjithë botën dhe mbi 3 800 kanë vdekur.



MKRS e UP nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka nënshkruar të hënën memorandumin e bashkëpunimit me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", të cilin e ka nënshkruar rektori i këtij universiteti, Marjan Dema.

Ky memorandum i bashkëpunimit ka për qëllim ta mbështesë Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" për organizimin e "Javës së Universitetit" dhe për manifestimin qendror për 50-vjetorin e themelimit të

Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Ministrja Dumoshi u shpreh shumë e nderuar që ministria që ajo drejton ka mundësinë ta mbështesë Universitetin e Prishtinës në këtë vit jubilar e të rëndësishëm për dijen dhe kulturën. "Universiteti i Prishtinës, përpos që është vatër e dijes dhe e konsolidimit kombëtar të Kosovës, ka luajtur rolin e patjetërsueshëm historik të shtetbërjes dhe në këtë gjysëmshkull jetë të tij, institucioni kryesor në fushën e arsimit duhet të përkrahet në

maksimum sepse kësajsoj avancohen dija, shkenca, kultura dhe çdo fushë tjetër në Republikën e Kosovës", ka vlerësuar ministrja Dumoshi. Rektori Demaj e ka falënderuar ministren Dumoshi e cila, sipas tij, "që prej marrjes së mandatit ka shprehur vullnetin e gatishmërinë të jetë bashkëpunëtorë për avancimin e dijes e të arsimitit përmes Universitetit të Prishtinës, duke u kontribuar kështu gjeneratave të reja që po shkollohen e edukohen në Prishtinë".



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka takuar liderët e partive politike në lidhje me koordinimin për çështje të inte

Presidenti bën përpjekje të krijoj

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar nga liderët politikë unitet për dialogun me Serbinë. Teksa të hënën i ka takuar liderët partiakë ndaras dhe i ka informuar ata për takimin me presidentin serb në Shtëpinë e Bardhë, Thaçi ka kërkuar mbështetjen e tyre në këtë proces. Pasi ka përfunduar takimet me liderët e partive politike, presidenti Thaçi ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën ka thënë se vetëm të bashkuar Kosova mund të dalë fituese në këtë proces të dialogut me Serbinë. Në takimin e thirrur nga presidenti nuk ka shkuar vetëm lideri i Vetëvendosjes, njëherësh kryeministër, Albin Kurti

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 MARS - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka njoftuar të hënën liderët e partive politike për takimin që ka pasur me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Shtëpinë e Bardhë. Në takimet e ndara me ta, shefi i shtetit ka kërkuar unitet politik për procesin final të dialogut me Serbinë. Pas takimeve, Thaçi ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën ka falënderuar të gjithë liderët për takimet konstruktive, duke thënë se Kosova ka nevojë për qëndrime unike rreth çështjeve nacionale.

Ai ka deklaruar se vetëm të bashkuar Kosova mund të ketë sukses në fazën finale të dialogut me Serbinë. “Në kuadër të

transparencës së plotë dhe bashkëpërgjegjësisë që kemi, unë sot kam zhvilluar takime me liderët institucionalë dhe politikë, duke filluar me ish-kryeministrin, liderin e LDK-së, z. Isa Mustafa, që ka qenë një takim i shkëlqyer. Kemi diskutuar për këtë proces që po kalojmë dhe u pajtuam që të kemi qëndrim të përbashkët me çështjet me rëndësi vitale, konsolidim të brendshëm dhe të jashtëm. E vlerësoj lart kontributin e z. Mustafa që gjithmonë ka luajtur një rol konstruktiv”, ka thënë Thaçi.

Takime konstruktive ai i ka vlerësuar edhe takimet me liderin e PDK-së, Kadri Veseli, atë të AAK-së, Ramush Haradinaj dhe liderin e Nismës, Fatmir Limaj. “Po ashtu, me Kadri Veselin diskutuam për rolin e

opozitës si gurthemel për realizimin e çështjeve të interesit të përbashkët. Takim miqësor pata edhe me ish- kryeministrin Ramush Haradinaj i cili përkrah përpjekjet për një qëndrim të përbashkët madhor shtetëror dhe e vlerësoj lart. Edhe me Fatmir Limajn u pajtuam që të flasim me një zë. Një takim të mirë pata edhe me Listën Serbe.

Roli i saj është i rëndësishë së veçantë për ndërtimin e shtetit dhe shoqërinë shumëtnike. Është me interes që të punojmë bashkë”, ka thënë Thaçi. Për refuzimin që lideri i LV-së, Albin Kurti, i ka bërë takimit, Thaçi ka thënë se Kosova nuk ka kohë për të humbur. “Për hir të transparencës së plotë për sot ka qenë e konfirmuar që të ndodhë

edhe një takim me kryeministrin Albin Kurti. Mirëpo, për fat të keq, edhe pse takimi ka qenë i konfirmuar nga zyra e tij qysh të premtën në mesditë, me kërkesën e tij, takimi ishte planifikuar që të ndodhë në orën 13:00. Por, për fat të keq, 5 minuta para orës 13:00 është anuluar”, ka deklaruar presidenti, duke shtuar se Kurtin do ta takojë në ditët në



Ministrja Dumoshi: Për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave do të angazhohem çdo ditë

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ishte e pranishme në takimin e organizuar me iniciativën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti dhe nën organizimin e Agjencisë për Barazi Gjinore, për shënimin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Në fjalën e saj ministrja Dumoshi tha se debati për të drejtat e

grave është debat që duhet të bëhet jo vetëm për 8 mars. “Jemi zotuar që papunësia te gratë të jetë një prej problemeve që do të trajtojmë me programin qeverisës, andaj angazhimi drejt barazisë do të jetë shqetësim i përditshëm për secilin vendim që marrim”, ka treguar Dumoshi. Ajo u zotua se do ta shtyjë përpara agjendën për promovimin e të drejtat e grave si ministre, në të gjitha dikasteret

që drejton, dhe siguroi të gjitha organizatat dhe iniciativat që kanë për vizion mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të grave, se do ta kenë përkrahjen e ministrit që ajo drejton. Shënimi i kësaj dite u bë përmes lansimit të Amendamentimit të Kornizës Ligjore për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, me ç’rast u prezantua edhe drafti final i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore.



resit shtetëror

ë unitet për dialogun me Serbinë



humbur dhe për të mbetur viktimë, për teke e huje të asnjërit prej nesh”, ka thënë Thaçi.

Ai ka bërë me dije se qëndrimi i përbashkët ndërmjet opozitës dhe pozitës është thelbësor në çështjet me interes kombëtar. “Shteti ynë, qytetarët tanë, nuk kanë kohë për të humbur me teket dhe hujet e askujt. Ku ka qenë uniteti dhe bashkimi, kam qenë gjithmonë edhe vetë dhe kemi pasur sukses të plotë, prandaj merreni dhe bëjeni një krahasim kush ka munguar në sukseset dhe unitetet e Kosovës, pastaj e gjeni adresën e të munguarit në sukses dhe në unitet”, ka deklaruar ai.

Thaçi ka thënë se Kosova tani ka nevojë për unitet politik e institucional. “Kur kemi qenë të bashkuar kemi pasur suksese e besoj se do të kemi sukses edhe tash. Askush i vetmuar nuk do të mund t’i realizojë objektivat qytetare, kushtetuese e ligjore dhe t’i hapë perspektivë vendit, perspektivë zhvillimore, në të njëjtën kohë euroatlantike”, ka thënë Thaçi.

Haradinaj dhe Limaj komentojnë takimin me presidentin

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka qenë lideri i parë politik që ka pritur presidenti Hashim Thaçi. Mysafiri i dytë që ka shkuar në zyrë të presidentit ka qenë lideri i

PDK-së, Kadri Veseli. Mustafa dhe lideri i LDK-së, Veseli, nuk e kanë komentuar takimin me presidentin. Ndërsa pas takimit me presidentin, ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar se presidenti e ka informuar për takimin me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në ShBA. Ai ka deklaruar se Thaçi e ka njoftuar se në takimin në Shtëpinë e Bardhë është biseduar se si të ecet përpara drejt marrëveshjes finale me Serbinë. “Është një takim i ftuar prej presidentit për konsultë dhe për informim për takimet në Uashington të Thaçit me presidentin Vuçiq. Do t’u përgjigjem takimeve bilaterale si të presidentit ashtu edhe të institucioneve të tjera”, ka thënë Haradinaj.

Ai ka mohuar se në këtë takim është prezantuar ndonjë dokument apo diçka konkrete. “Nuk ka nxjerrë ndonjë dokument, por shpjegime ka dhënë se është biseduar për mundësinë e ecjes përpara për një marrëveshje përfundimtare”, ka thënë Haradinaj. Ai ka theksuar se procesi i dialogut me Serbinë ka shanse nëse respektohet integriteti territorial i Kosovës dhe Kushtetuta, duke shtuar se nëse trajtohet territori i Kosovës ose korrigjimi i kufijve, atëherë ky proces do të dështojë. Kurse kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, pas takimit me presidentin Hashim Thaçi, ka thënë se Nisma

Kurti nuk shkon te Thaçi

Kryeministri i Kosovës dhe lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, nuk ka pranuar ftesën e presidentit Hashim Thaçi për takim të hënën.

Zyra e Presidentit në një përgjigje për medie ka sqaruar se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njëherësh lider i Vetëvendosjes, e kishte konfirmuar takimin me presidentin Thaçi në orën 13:00. Por, ky takim, sipas Zyrës së Presidentit, është anuluar pak minuta para orës 13:00. Ndërsa kabineti i kryeministrit Albin Kurti përmes një deklarate për media ka thënë se Kurti në vend të takimit me

Thaçin do të jetë pjesë e seancës së Kuvendit të Kosovës, në të cilin do të flasë Vasfije Krasniqi-Goodman, një prej viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. Kabineti i Kurti ka përmendur edhe arsyet e tjera për të mos e takuar presidentin. “Presidenti sot e paska lënë t’i takojë krerët e partive. Si kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje nuk kam as interes e as gatishmëri ta takoj presidentin aktual. Si kryeministër e kam obligim. Takohemi një ditë tjetër kur të mbarojë me partitë”, është thënë në arsyetimin e kryeministrit Kurti.

është në shërbim të temave nacionale, por nuk është në shërbim të egove individuale. “Shtetet e Bashkuara kanë arritur objektivat e veta. Askush nuk duhet të frikësohet apo të hezitojë aty ku drejton ShBA-ja. Kosova duhet të rreshtohet fuqishëm për të vazhduar mbylljen e dialogut Kosovë - Serbi. Ky ka qenë qëndrimi që ia kam thënë edhe Thaçit”, ka thënë Limaj.

Ai ka shtuar se qëndrimi i Nismës Socialdemokrate vazhdimisht ka qenë për konsensus në temat kombëtare. “Koha është që të gjithë të kuptojmë se në çfarë faze dhe situatë është Kosova dhe procesi i dialogut. Mungesa e seriozitetit dhe injorimi i kësaj

çështje mund t’i kushtojë Kosovës siç i ka kushtuar posaçërisht në vitet e fundit. Nëse vazhdohet me sjellje të tillë, do të kemi edhe më tepër telashe”, është shprehur Limaj.

Më pas, presidenti ka treguar se në pamundësi të pjesëmarrjes në takim për shkaqe teknike, ka zhvilluar një bisedë telefonike me liderin e AKR-së, Behgjet Pacolli, me të cilin është pajtuar që t’i bashkërendojnë të gjitha veprimet për të mirën e qytetarëve të vendit tonë dhe për interesat shtetërore. Të hënën presidenti Thaçi është takuar edhe me përfaqësuesit e Listës Serbe dhe përfaqësuesit e partive të tjera minoritare.



Osmani: Diaspora duhet të trajtohet përtej remitencave

Në këtë kontekst, është diskutuar edhe për potencialin që ofron diaspora si në aspektin e zhvillimit ekonomik, po ashtu edhe me ofrimin e kapaciteteve profesionale

Prishtinë, 9 mars (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritë në një takim bordin e organizatës joqeveritare “Germin” e cila merret me çështje të diasporës. Kryetarja Osmani ka thënë se diaspora nuk duhet të trajtohet në nivel

të remitencave dhe ndihmës familjare. Në këtë kontekst, është diskutuar edhe për potencialin që ofron diaspora si në aspektin e zhvillimit ekonomik, po ashtu edhe me ofrimin e kapaciteteve profesionale. Ndërkaq përfaqësues të kësaj organizate

kanë thënë se janë të interesuar ta mbështesin punën e institucioneve të Kosovës me ekspertë nga diaspora të fushave të ndryshme. Në këtë takim është ngritur edhe çështja e të drejtës së votës së diasporës dhe përmirësimit të kornizës ligjore për këtë çështje.



Veliu: Policia e Kosovës para vetes ende ka sfida të mëdha

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 MARS - Policia e Kosovës së bashku me Shoqatën Ndërkombëtare të Grave në Polici (IAWP), Shoqatën e Grave në Policinë e Kosovës (AWKP), Organizatën për Bashkëpunim të Sigurisë në Evropë (OSBE), Misioni në Kosovë dhe Programin Ndërkombëtar të Trajnimit të Hetimit Penal në ShBA (ICITAP), organizuan Konferencën Ndërkombëtare “Roli i grave në polici në përgjigje të kërcënimeve trans nacionale”. Konferenca është dyditore dhe do të sjellë së bashku gra dhe burra, përfaqësues të forcave ndërkombëtare të policisë nga e gjithë bota, përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, shoqërinë civile dhe media për ta adresuar së bashku rëndësinë e kontributit të grave në paqe dhe siguri. Në këtë konferencë mori pjesë edhe ministri i Punëve të Brendshme dhe Administratës

Publike, Agim Veliu. Ai ka shprehur përkrahjen dhe mbështetjen për punën e tyre në shërbim të shtetit, në mbrojtje të rendit dhe ligjit dhe në angazhimin për mirëqenien e qytetarëve të Kosovës pa dallim. Veliu ka theksuar se sfidat e sigurisë, të cilat i kemi përpara, janë obligim që të ofrojnë zgjidhje dhe siguri për të gjithë qytetarët e Kosovës, tolerancë zero ndaj krimit dhe korrupsionit. “Sundimi i ligjit është prioriteti im dhe i Qeverisë së Kosovës. Ne jemi të përkushtuar, me të gjitha kapacitetet në kuadër të MPBAP-së, e me theks të veçantë të Policisë së Kosovës, që me përkushtim dhe vullnet të jemi në nivel të lartë të detyrës dhe të kemi një Kosovë të qetë e të sigurt. Trajtimi me dinjitet i Policisë së Kosovës, ngritja dhe avancimi i kapaciteteve njerëzore brenda Policisë së Kosovës është prioritet për ne. Bashkë do të angazhohemi për përmirësimin e kushteve të



punës dhe për ruajtjen e dinjitetit të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës”, është shprehur Veliu. Ai ka theksuar se Policia e Kosovës ka qenë nismëtare e një procesi të madh që prej vitit 1999, ku në mënyrë të barabartë dhe pa dallim ka filluar rekrutimin e grave në radhët e

tyre. “Nëse shikojmë në retrospektivë, ky ishte një hap i madh dhe i përcjellë me shumë të panjohura. Vullneti dhe gatishmëria e grave kosovare edhe një herë ka treguar se për to asgjë nuk është e pamundur. Sot në radhët e Policisë së Kosovës me krenari mund të konstatojmë se kemi 15 për qind të grave të

përfaqësuar në të gjitha nivelet e strukturës policore. E di që është numër i vogël, por mbështes gra police profesionale dhe të afta për punën e tyre. Policia e Kosovës ka në radhët e veta vajzat dhe djemtë më të mirë të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë”, ka theksuar ministri Veliu, duke shtuar se Policia e Kosovës është nga më të mirat në rajon. “Policia e Kosovës është fuqia e shtetit dhe garancia më e mirë e sigurisë, e stabilitetit dhe e qëndrueshmërisë së Republikës së Kosovës”, ka thënë ai.

Ministri Veliu ka pohuar se Policia e Kosovës para vetes ka ende sfida të mëdha. “Në mesin e atyre janë: forcimi i luftës kundër të gjitha formave të krimit të organizuar, korrupsionit, ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit, krimeve ekonomike dhe menaxhimit të migrimit, por me vullnetin tuaj dhe me një punë të shkëlqyer shoh se mund t’ia dalim”, ka deklaruar Veliu.

KPK-ja dhe KGjK-ja nënshkruajnë marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike dhe për mirëmbajtjen dhe avancimin e përbashkët të SMIL-it, marrëveshje kjo e cila u nënshkrua nga kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni dhe kryesuesi i KGjK-së, Skender Çoçaj, me ç’rast ishin të pranishëm edhe ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl dhe përfaqësues të institucioneve të tjera vendore dhe ndërkombëtare. Me këtë rast, kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni, ka falënderuar shtetin e Norvegjisë, i cili mundësoi realizimin e projektit të Sistemit për Menaxhimin



Informativ të Lëndëve (SMIL), duke theksuar se lansimi i shkëmbimit të të dhënave në mënyrë elektronike nga prokuroria në gjykatë dhe anasjelltas do të mundësojë komunikim të shpejtë dhe të

sigurt, si dhe do të ketë përfitime të mëdha për të dyja institucionet, duke filluar nga kursimi i kohës për dorëzimin e lëndëve fizike, kursimi në kopjimin e lëndës në disa kopje, në pajisje për skanim të lëndëve,

resurset njerëzore dhe, ç’është më kryesorja, që të dhënat e dërguara - pranuar nuk mund të humbin apo të fshihen. Nga ana tjetër, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Skender Çoçaj, ka thënë se nënshkrimi i

marrëveshjes për ndërlidhje të sistemeve të gjykatave dhe prokurorive është i një rëndësie të madhe për proceset e reja, ngaqë përbën një avancim efektiv të procesit të punës në gjykata dhe prokurori, duke mundësuar shkëmbimin e shpejtë dhe të saktë të të dhënave, proces ky që do të vazhdojë për avancimin e mëtejshëm të SMIL-it.

Ndërsa ambasadori norvegjez në Kosovë, Jens Erik Grondahl, ka thënë se beson se ky projekt do të sjellë transparencë dhe do të shohim efekte pozitive në punën e sistemit prokurorial dhe gjyqësor të Kosovës. Pas ceremonisë së nënshkrimit është bërë prezantimi i shkëmbimit të të dhënave elektronike në mes të KPK-së dhe KGjK-së.

Haxhiu vizitoi Shoqatën “Thirrjet e Nënave” në Ditën Ndërkombëtare të Gruas

PRISHTINË 9 MARS (ER) - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, me rastin e 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ka vizituar përfaqësueset e Shoqatës “Thirrjet e Nënave”, me të cilat ka diskutuar për çështjen e zbardhjes së të pagjeturve nga lufta në Kosovë. Në këtë takim ministria Haxhiu shprehu zotimin se do ta bëjnë të pamundurën që të zbulohet

fati i të pagjeturve dhe që kriminelët e luftës të dalin para drejtësisë, duke shtuar se diçka e tillë është paraparë edhe me programin qeverisës lidhur me hetimin, dokumentimin dhe arkivimin e krimeve të luftës. Ministria theksoi se aktivizmi dhe mosdorëzimi i këtyre grave në kërkim të drejtësisë është shtysë për secilin institucion që të angazhohet që drejtësia

për këto familje të vihet në vend. Përfaqësueset e kësaj shoqate e falënderuan ministren Haxhiu për vizitën e saj në një datë kaq të rëndësishme për gratë siç është 8 Marsi, duke shprehur besimin e tyre për bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë për zbardhjen e fatit të familjarëve të tyre.



Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë të veçantë, e cila i është kushtuar ngritjes së vetëdijes së shoqërisë për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë

Vasfije Krasniqi-Goodman, deputetëve: Krimet e luftës të merren seriozisht

E mbijetuara e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Vasfije Krasniqi-Goodman, në fjalën e saj para deputetëve të Kuvendit të Kosovës ka thënë të hënën se nga shteti kërkojnë drejtësi, kurse nga familjarët mbështetje. Ajo ka kërkuar nga deputetët që të merret seriozisht trajtimi i kësaj kategorie dhe të dënohen kryesit e veprave



EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 MARS - Me rastin e shënimit të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka organizuar të hënën seancë të veçantë, e cila i është kushtuar ngritjes së vetëdijes së shoqërisë për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Deputetëve të Kuvendit të Republikës u është drejtuar edhe Vasfije Krasniqi-Goodman, e cila ka thënë se shoqëria e Kosovës po stigmatizon viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës. Krasniqi-Goodman, një prej të mbijetuarave të kësaj dhune të luftës së fundit në Kosovë, të viteve 1998-1999, ka pohuar se nga shteti kërkojnë drejtësi, kurse nga familjarët mbështetje.

Krasniqi-Goodman ka thënë se edhe në ligjin e miratuar nga Kuvendi, të dhunuarat quhen viktimat, ndonëse kjo kategori bën pjesë në personat e mbijetuar të luftës. Ajo ka thënë se kjo kategori e shoqërisë është lënduar edhe nga fjalimet e deputetëve nga foltorja e Kuvendit të Kosovës. “Vendi ynë, shoqëria jonë ne na stigmatizon. Na bën që mos të ndihemi vajza, motra, gra, por edhe nëna të mira. Po ku ishit ju atëherë, para 21 vjetësh? A ishit në tavan kur ju dhunua gruaja nëpër dhoma? Ku e morët guximin ju t’i braktisni

gruan dhe fëmijët? Ku ishin djemtë që e panë nënën duke e dhunuar, e përzunë nënën, kurse e mbajtën gruan në shtëpi sepse nuk e dinte se edhe gruan e kishte të dhunuar? Ku ishit ju kur u dhunua Jeta shtatëvjeçare? E tash ju çka po bëni për të na lehtësuar neve jetën? Duhet t’u vijë turp të gjithëve, gjithë shoqërisë së Kosovës, sepse po na viktimizoni për çdo ditë”, ka deklaruar ajo.

Krasniqi-Goodman ka kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që të merret seriozisht trajtimi i kësaj kategorie dhe të dënohen kryesit e veprave. “Duhet të ndryshoni sepse ka ardhur fundi. Që 20 vjet mjaft kemi duruar, por më nuk mund t’jua falim atë që na keni bërë, të durojmë për dy dekada. Në fund i lus të gjithë deputetët, institucionet e Kosovës, që krimet e luftës dhe dënimet të merren seriozisht. Që 20 vjet asnjë person nuk është ndëshkuar për këto krime”, ka thënë Krasniqi-Goodman.

Vasfije Krasniqi-Goodman në vitin 2018 ka rrëfyer publikisht historinë e saj në Kosovë, që i kishte ndodhur 19 vjet më parë. Ajo ka rrëfyer për historinë e saj edhe në një seancë të mbajtur në vitin 2019 në Komitetin për Marrëdhënie me Jashtë të Shteteve të Bashkuara, me temën “Viktimat e luftës në Kosovë”.

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se seanca

e sotme ka pasur një qëllim: që këtë vit t’ia kushtojnë zanit të mbytur të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. “Në mënyrë që atë zë ta shumëfishojmë, që të ndikojmë sadopak në ngritjen e vetëdijes për zërin e heshtur dhe për drejtësinë e munguar për viktimat e kësaj dhune”, ka thënë ajo.

Osmani ka pohuar se zëri i Vasfijes, e cila guximshëm e nisi një mision të shenjtë, ngritjen e zërit kundër dhunës dhe kundër stigmës, duke iu adresuar fillimisht Kongresit Amerikan, pastaj Parlamentit të Suedisë dhe Senatit Italian, është zëri i këtyre mijëra viktimave që kërkojnë drejtësi. “Duke e ndarë historinë e saj me ne, ajo jo vetëm do ta kujtojë fatin e viktimave, por do të na ndihmojmë që ta zgjojmë zërin e ndërgjegjes brenda nesh dhe të thërrasim fort për drejtësi”, ka deklaruar Osmani.

Ajo ka thënë se është e dhimbshme që dy dekada pas luftës tregimet e torturës dhe abuzimit seksual po mbahen të

heshtura dhe jashtë metanarracionit të luftës dhe diskursit publik. “Dhuna seksuale është ndër më çnjerëzoret ngaqë në njërin anë e shpërfaq egërsinë e vrasësit dhe, në anën tjetër, i kërkon viktimës ta heshtë krimin. Por, heshtja e krimit nuk e zhbën atë. Përkundrazi, e bën dyfish më të rëndë. Të mos rrëfesh për krimin sepse mund të paragjykohesh, është sikur ta mohosh atë; të mos ua njohësh statusin e vërtetë viktimave të dhunës është sikur të mos e pranosh viktimën e fatin e tmerrshëm të saj. Të mos e kërkos me ngulm drejtësinë për këto viktimat është sikur ta mohosh fatin e tyre”, ka thënë kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani.

Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë se nuk mund as t’i imagjinojnë dhimbjet dhe tmerrin që viktimat seksuale të luftës kanë përjetuar, por edhe vuajtjet e vazhdueshme pas luftës duke jetuar të heshtur, të izoluar e të harruar. “Si qytetar, aktivist dhe deputet i Kuvendit të Republikës e kam pasur për detyrë të flas e të kërkoj veprim shtetëror, sot si kryeministër e kam për detyrë të vepro. Kriminelët e luftës duhet të dënohen për krimet e shkaktuara në të gjitha frontet”, ka thënë Kurti.

Ai ka theksuar se gjykatat dhe prokuroritë tona duhet t’i trajtojnë me seriozitetin maksimal rastet e dhunës seksuale në Kosovë. “Legjislatura e kaluar e Kuvendit ka miratuar ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale që lejon gjykimin në mungesë për krime lufte, çka do të thotë se institucionet e Kosovës kanë të drejtë t’i nisin hetimet edhe nëse i dyshuari nuk është në seancë gjatë gjykimin. Qeveria është e gatshme të plotësojë çdo kërkesë të prokurorisë për t’i

rritur kapacitetet e nevojshme në këtë drejtim. Përdhunimet gjatë luftës janë nga krimet më të tmerrshme që kanë ndodhur, por ato asnjëherë nuk u trajtuan në bisedimet me Serbinë. Ne do të sigurohemi që kjo të ndryshojë, sepse nuk mund të arrijmë paqe pa pranuar të kaluarën. Kërkimfalja nga Serbia, reparacionet dhe qasja në drejtësi do të jenë pjesë e dialogut”, është shprehur Kurti, duke shtuar se një ndër prioritetet e qeverisë është padia e Kosovës për gjenocid kundër Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. “Kjo do të jetë rrugë e gjatë, sepse dëshirojmë që të sigurohemi që të jemi të suksesshëm në këtë proces, por ne veçse kemi filluar punën në këtë drejtim. Pa ndëshkimin e krimeve të luftës nuk mund të kemi qetësi. Krimet e luftës, gjenocidi e krimet kundër njerëzimit nuk janë të kaluara derisa dikush nuk merr përgjegjësi për to”, ka deklaruar kryeministri Kurti.

Bazuar në deklaratat dhe shifrat e prezantuara nga institucionet e Kosovës, gjatë luftës së viteve 1998-1999 janë rreth 20 000 raste të dhunimeve seksuale nga pjesëtarë të forcave serbe.

Viktimat e dhunës seksuale tashmë kanë kërkuar edhe drejtësi ndërkombëtare. Vitin e kaluar Bordi Drejtues i Grave të Kosovës ka dorëzuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara peticionin e qytetarëve të Kosovës përmes të cilit kërkohet drejtësi ndërkombëtare. Ky peticion ishte nënshkruar në vitin 2014, nga më shumë se 110 mijë qytetarë në gjithë territorin e Kosovës, përjashtuar komunat e banuara me shumicë serbe. Synim i këtij peticioni ka qenë dhe mbetet që, siç thuhet, “kryesit e krimeve gjenocidale në Kosovë” të dalin para organeve të drejtësisë.



Emilija Rexhepi: Investimet e para nga MAPL-ja do të shkojnë në Prizren

Prizren, 9 mars (ER) - Më 6 mars ministrja e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Emilija Rexhepi, ka filluar vizitën zyrtare në komunat e Kosovës. E shoqëruar nga kabineti i saj, ajo ka vizituar Komunën e Prizrenit. Me këtë rast, ministrja Rexhepi u takua me kryetarin Mytaher Haskuka. Sipas njoftimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, qëllimi i vizitës ishte informimi i ministres së MAPL-së me problemet me të cilat ballafaqohet kjo qeveri lokale. Ministrja Rexhepi ka theksuar mbështetjen e plotë të Komunës së Prizrenit, duke shtuar se investimet e para nga MAPL do të shkojnë në Prizren. “Mbështetja u paralajmërua përmes projekteve të infrastrukturës, ndërtimit të një kopshti fëmijësh, ndërtimin e

një shtëpie për të moshuarit, financimin e rrethojave për zonën industriale, projektet e infrastrukturës për regionin e Zhupës dhe Podgorës, përfundimin e punimeve në Qendrën Kulturore Boshnjake, zbatimin e programit qeveritar të kryeministrit Kurti për zhvillimin e politikave ekonomike dhe sociale të qytetit të Prizrenit dhe investime të mëdha kapitale”, është bërë me dije në njoftimin e MAPL-së.

Po ashtu, ministrja Rexhepi ka theksuar rëndësinë e multietnicitetit të Prizrenit dhe, në të njëjtën kohë, ka kërkuar nga kryetari i komunës një respekt të konsiderueshëm për përdorimin e gjuhëve si dhe përfshirje më të madhe të komuniteteve pakicë në të gjitha proceset që zhvillohen në



këtë komunë.

Kryetari Haskuka e ka falënderuar ministren Rexhepi

për vizitën e saj dhe ka shprehur gatishmërinë e tij të plotë për të bashkëpunuar në

mënyrë që të krijojë kushte më të mira të jetesës për të gjitha komunitetet në Prizren.

KRU ‘Hidrodrini’ mbulon shpenzimet e rrymës së pompave për 12 fshatrat e Istogut



Istog, 9 mars (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjetësimit “Hidrodrini” ka njoftuar se do t’i mbulojë shpenzimet e energjisë elektrike për tre rezervarët e pompimit, 600, 300 dhe 150 metra kub ujë. Këto pompa do të

ndërtohen në kuadër të projektit për ndërtimin ujësjetësimit për zonën lindore të Komunës së Istogut, nga i cili do të përfitojnë 12 fshatra të këtij rajoni. “Me këtë zotim dhe mbulueshmëri financiare të shpenzimeve të

energjisë për pompa, nga KRU ‘Hidrodrini’ në Pejë, konsumatorëve të fshatrave përfituese, Shushicë, Rakosh, Zhakovë, Uçë, Bollopojë, Veriq, Mojtir, Syne, Cerkolez, Syrganë, Kerrninë dhe

Padalishtë do t’u mbetet të mbulojnë me pagesë, vetëm faturat mujore të ujit që do t’i shpenzojnë”, ka deklaruar kryeshefi ekzekutiv i kompanisë, Agron Tigani. Nga projekti do të përfitojnë

rreth 8 000 konsumatorë të rajonit në fjalë, të cilët me përfundimin e projektit, që sipas dinamikës pritet të zgjasë një vit nga dita e fillimit të punimeve, do të kenë furnizim 24 orë me ujë të pijshëm.

Kosnetti takohet me Abdixhikun, mirëpret luftën kundër korrupsionit

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, të hënën ka pritur në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett. Në këtë takim njoftues Abdixhiku e informoi ambasadorin se çfarë është

paraparë në planin qeverisës për infrastrukturën dhe mjedisin, përfshirë këtu edhe projektet të cilat do të trajtohen me prioritet.

Më tutje, ministri ka theksuar vendosmërinë e tij për ta bërë MIA-n si një nga ministritë më të mëdha në Qeverinë e

Republikës së Kosovës, një dikaster transparent për të gjithë. Ambasadori Kosnett tha se mirëpret luftën kundër korrupsionit dhe shprehu gatishmërinë për t’i ndihmuar institucionet e vendit për realizimin e punëve të mira për Kosovën.



Ligji i ri gjerman rrezikon ikjen e ‘trurit’ nga Kosova

PRISHTINË, 9 MARS - Ligji mbi emigrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar në Gjermani, i cili ka hyrë në fuqi në mars të këtij viti, ka ngritur shqetësime në Kosovë se një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, kryesisht atyre të kualifikuar, do ta lëshojnë vendin. Përfaqësues të bizneseve dhe shoqërisë civile thonë se disa vjet që me ikjen e qytetarëve të Kosovës nga vendi po rrezikohet edhe humbja e fuqisë punëtore. Kurse me miratimin e ligjit të ri gjerman shqetësimet janë ngritur për humbjen e fuqisë së kualifikuar punëtore apo “trurit të Kosovës”.

Instituti për Studime të Avancuara (GAP) ka bërë një hulumtim lidhur me emigrimin e fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani.

Blend Hyseni, hulumtues i lartë në Institutin GAP, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se në bazë të një hulumtimi që kanë bërë, një rregullore e vitit 2015 e shtetit gjerman dhe ligji tjetër i cili ka hyrë në fuqi së fundmi, që të dyja bashkë, mundësojnë emigrimin e fuqisë punëtore nga Kosova në Gjermani. “Ikja e fuqisë punëtore të Kosovës rrezikohet më shumë nga rregullorja e vitit 2015 e aprovuar nga Gjermania e cila u jep mundësi më të lehtë në tregun e punës gjerman qytetarëve të vendeve të

Ballkanit Perëndimor dhe e cila është ende në fuqi dhe që në një formë kishte lehtësuar emigrimin”, thotë Hyseni.

Më 2015 Gjermania pati hapur tregun e punës për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, në përgjigje të një rregulloreje që u miratua dhe ftonte punëtorët e kualifikuar dhe të pakualifikuar në tregun gjerman të punës mbi bazën e ofrimit të një vendi të punës.

Hyseni thotë se pas miratimit të kësaj rregulloreje, nga viti 2016 deri në vitin 2018, mbi 15 000 qytetarë nga Kosova kanë arritur të marrin viza dhe të shkojnë në Gjermani. Personat të cilët janë pajisur më vizë gjatë këtyre viteve dhe kanë shkuar në Gjermani janë të profileve si, ndërtimtaria, hoteleria dhe shërbimet e kujdesit.

Kurse në mars të këtij viti në Gjermani ka hyrë në fuqi edhe Ligji mbi imigrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar, i cili u mundëson punonjësve të kualifikuar në arsim profesional nga shtetet jashtë Bashkimit Evropian të emigrojnë më lehtë në të ardhmen në drejtim të Gjermanisë.

Për dallim nga rregullorja e vitit 2015 e cila u mundësonte punëtorëve nga profile të ndryshme të kërkojnë punë në Gjermani, me ligjin e ri kryesisht kërkojnë punëtorë të kualifikuar. Pronarë të bizneseve



prodhuese në Kosovë thonë se duhet të ndërmerren hapa urgjentë për të krijuar kushte më të mira për të rinjtë në mënyrë që ata të mos ikin nga vendi.

Shaqir Palushi, pronar i kompanisë për prodhimin e pijeve joalkoolike dhe energjike ‘Frutex’, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se, përveç institucioneve, edhe bizneset duhet të krijojnë kushte të mira për punëtorët, në mënyrë që këta të fundit ta shohin Kosovën si vend ku mund të jetohet dhe punohet. “Aktualisht ka një interesim më të madh të qytetarëve dhe sidomos të rinjtë që të sigurojnë viza pune

në Gjermani, por nëse flasim për kompaninë tonë, nuk kemi vërejtur ndonjë ndryshim, përkatësisht rritje të kërkesës për largim nga vendet e punës, ndoshta arsyeja është se te ne pagat janë pak më të larta sesa mesatarja në sektorin privat. Është e nevojshme që edhe ne si punëdhënës të reflektojmë karshi kësaj situate të krijuar dhe t’i rrisim pagat dhe t’i përmirësojmë kushtet e punës në mënyrë që kjo tendencë e ikjes të zvogëlohet”, thotë Palushi.

Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë ka dhënë informacione rreth Ligjit mbi

imigrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar. Sipas një postimi në faqen zyrtare të kësaj ambasade, thuhet “se ligji u krijon mundësi të reja punonjësve me kualifikim të njohur në arsim profesional nga shtetet joanëtare të Bashkimit Evropian për të punuar në Gjermani”. Për hyrjen në Gjermani, me qëllim të krijimit të një marrëdhënie punësimi apo kërkimi të një vendi pune, Ambasada e Gjermanisë njofton se do të vazhdojë të jetë e nevojshme pajisja me vizë, për të cilën duhet të aplikohet pranë Ambasadës së Gjermanisë në Prishtinë.

GAP-i: Kuvendi ta rishikojë vendimin e BQK-së për shtrenjtimin e sigurimit të veturave

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Instituti për Studime të Avancuara (GAP) ka publikuar raportin “Shtrenjtimi i sigurimit të veturave: mostransparenca dhe kufizimi i konkurrencës së lirë”. Sipas GAP-it, edhe pse vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës ka ndikim të madh ekonomik, qoftë për qytetarët apo industrinë e sigurimeve, as vendimi e as raporti i vlerësimit (aktuarial) nuk janë bërë publike. “Për më tepër, vendimi nuk është në përputhje me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe me opinionin profesional të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK). Më 31 tetor 2019 Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Kosovës, i përbërë nga guvernatori dhe dy zëvendësguvernatorët, mori vendim që tarifat për automjete për pasagjerë (kategoria 1) për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia të rriten për 26

për qind. Ndonëse rishikimi i tarifave është në përputhje me rekomandimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, ky institucion nuk sugjeron ndonjë normë të caktuar të rritjes, por vetëm konstaton se në rishikimin e tarifave duhet të merren parasysh zhvillimet e tregut, siç janë inflacioni në shpenzimet mjekësore, ndërrimi i sjelljes së shoferëve për shkak të teknologjisë apo ndryshimi i profileve të rrezikut si pasojë e vendimeve gjyqësore”, është në komunikatën e GAP-it, duke u shtuar se “BQK-ja nuk ka marrë parasysh raportin aktuarial e asnjërin nga këta faktorë, mirëpo ka ngritur tarifat në përputhje vetëm me shkallën e inflacionit gjatë periudhës 2002-2018, edhe pse FMN përmend se tarifat janë rishikuar në vitin 2011, e jo 2001 ashtu siç deklaroi BQK”.

Sipas GAP-it, ky vendim është në



kundërshtim edhe me opinionin profesional të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, megjithëse BQK-ja vetë e kishte iniciuar kërkesën ndaj AKK-së lidhur me përputhshmërinë e vendimit me parimet e konkurrencës së lirë. “Duke qenë

se kompanitë kanë strategji të ndryshme të shitjes, profile të ndryshme të klientëve, e strukturë të ndryshme të shpenzimeve, AKK kishte thënë se duhet të shmanget bashkëveprimi i kompanive dhe se caktimi i çmimit në mënyrë

uniforme është në kundërshtim me parimet e konkurrencës së lirë. Problem tjetër që ndikon në besueshmërinë e publikut ndaj këtij vendimi është transparenca e ulët e BQK-së gjatë dhe pas vendimmarrjes”, thuhet në komunikatën e GAP-it, duke u shtuar se as vendimi i bordit e as raporti aktuarial nuk janë publikuar në faqen e BQK-së. “Andaj, duke u bazuar në opinionin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi kapacitetet e aktuarit, Instituti GAP ngre dyshime mbi legjitimitetin e këtij vendimi. Duke pasur parasysh peshën e këtij vendimi, Instituti GAP i rekomandon Kuvendit të Kosovës të angazhojë një kompani ndërkombëtare profesionale e cila do të ndihmonte që të bëhej një rishikim profesional i vendimit për shtrenjtimin e sigurimit të veturave”, thuhet tutje në komunikatën e GAP-it.

Përrurohet objekti i qendrës me një ndalesë në Prizren



Prizren, 9 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me kryeministrin Albin Kurti, kanë përruruar projektin e qendrës me një ndalesë ("One Stop Shop"), i cili është realizuar nga ana e Komunës së Prizrenit dhe Ministria e Administratës Publike që tashmë është e integruar në Ministrinë e Brendshme. Gjatë kësaj

ceremonie kryeministri Kurti ka thënë se Prizreni është shembull për ofrimin e shërbimeve të shumta në të njëjtën hapësirë, duke ia kursyer qytetarit edhe kohën edhe paratë.

Kryeministri Kurti ka thënë se ky projekt që është realizuar në Prizren, si askund tjetër, është bërë edhe shembull për komunitet tjerë, por edhe për

qeverinë dhe shtetin. Ndërsa kryetari Haskuka ka falënderuar të gjithë ata që kontribuan në realizimin e këtij projekti, duke shtuar se me 56 sportele në katin e parë të administratës komunale do të ofrohen shërbime të shumta për qytetarë, me standarde të larta, në një ambient modern e të digjitalizuar.

Haskuka ka njoftuar se për

reformimin e shërbimeve të administratës publike, së bashku me Bankën Botërore dhe IFC-në, është bërë analizimi i 190 shërbimeve publike të ofruara në Komunën e Prizrenit, ku më shumë se 60 për qind të tyre janë thjeshtësuar. Në anën tjetër, drejtori i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Prizrenit, Osman Hajdari, ka

falënderuar qytetarët për mirëkuptimin e treguar gjatë periudhës së implementimit të projektit, ku shërbimet ishin rilokuar në disa pika të tjera. Në këtë ceremoni të pranishëm ishin edhe ministrja e Administrimit të Pushtetit Lokal, Emilija Rexhepi, deputetë të Kuvendit të Kosovës, zyrtarë komunalë dhe qytetarë të Prizrenit.

Bizneset në Mitrovicë vazhdojnë të mos punojnë të dielën



MITROVICË, 9 MARS (ER) - Të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve të Komunës së Mitrovicës e cila është drejtuar nga nënkryetari i komunës, Faruk Mujka. Në këtë mbledhje janë diskutuar tema me interes për qytetarët e kësaj komune. Fillimisht drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, ka njoftuar

ekzekutivin komunal në lidhje me largimin e panos së heroit Isa Boletini nga objekti i DKRS-së, për të cilën ka thënë se është vjetërsuar dhe dëmtuar, me ç'rast është kontaktuar një kompani e cila do të punojë një pano tjetër me konstrukt të qëndrueshëm dhe më të bukur.

Ndërsa drejtori i Inspeksionit,

Hysni Ahmeti, i ka informuar të pranishmit për kujdestaritë e organizuara nga Drejtoria e Inspeksionit, duke inspektuar subjektet afariste lidhur me vendimin për respektimin e orarit të punës, me ç'rast vendimi që dita e diel të jetë ditë pushimi për të gjitha bizneset në Mitrovicë është duke u respektuar në përpikëri.

Muharremaj kërkon nga drejtorët t'i realizojnë projektet sipas planifikimeve

Suharekë, 9 mars (ER) - Në mbledhjen e mbajtur të hënën, të Këshillit të Drejtorëve të Komunës së Suharekës, është diskutuar për realizimin e projekteve të

parapara si dhe për ato në realizim e sipër. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka kërkuar nga drejtorët që t'i realizojnë projektet e tyre të

parapara sipas agjendës. "Të gjithë drejtorët kanë raportuar për ecurinë e projekteve që po realizohen si dhe për planet e ditëve në vijim", ka njoftuar Komuna e Suharekës.



POLITIKA E JASHTME E KOSOVËS: KURTI NJË HAP PARA, THAÇI NJË HAP PRAPA, SHBA DHE BE-ja RIPOZICIONIM



Prof. Lisen BASHKURTI

Kohët e fundit situata në Kosovë duket se po tensionohet sërish. Në qendër të këtij tensioni qëndron çështja e rifillimit të dialogut Kosovë - Serbi deri në normalizimin e plotë të marrëdhënieve dhe njohjen reciproke nëpërmjet një marrëveshje përfundimtare midis palëve me ndërmjetësim dhe garanci nga ShBA dhe BE.

Në planin e brendshëm kosovar, shkaku i këtij tensionimi ka të bëjë me bipolaritetin e politikës së jashtme dhe diplomacisë së Kosovës, përqendruar te qeveria e re dhe te presidenti Thaçi. Ky bipolaritet, nëse do të thellohet siç po duket, do të shndërrohet në antagonizëm, në një kohë kur, më tepër se kurrë Kosovës i nevojitet unitet në koalicionin qeveritar dhe kohezion politik mbarëkombëtar, sidomos për politikën e jashtme dhe dialogun me Serbinë.

Një tranzicion i thellë po ndodh në politikën e Kosovës. Aktualisht qeveria Kurti duket se akoma nuk e ka marrë tërësisht në duart e saj politikën e jashtme dhe diplomacinë e Kosovës. Inercia e të qenit opozitarë e LV-LDK dhe Kurtit akoma vijon edhe në kushtet e marrjes së mazhorancës parlamentare dhe të qeverisjes së Kosovës.

Ndërkohë, presidenti Thaçi

vazhdon të sillet, deklarohet e të veprojë sikur të ishte mazhoranca dhe qeverisja e tij. Inercia e të qenit parti-shtet te presidenti Thaçi vijon edhe në kushtet kur Ai dhe partia e tij kanë humbur kompetencat kushtetuese dhe legjitimitimin popullor për t'i qeverisur politikatat publike, të brendshme dhe të jashtme të Kosovës.

1. Qeveria Kurti dhe koalicioni LV-LDK ta marrin në duar politikën e jashtme dhe diplomacinë

Për bipolarizimin e politikës së jashtme dhe diplomacisë së Kosovës në një farë mënyre përgjegjësia është e të dy palëve, qeverisë dhe presidentit. Qeveria Kurti duhet t'i marrë menjëherë dhe tërësisht përgjegjësitë e saj kushtetuese për drejtimin e politikave publike në Kosovë, përparësisht, politikën e jashtme dhe diplomacinë. Është momenti i vendimeve të rëndësishme që presin institucionet kushtetuese të Kosovës, Kuvendin dhe qeverinë të dala nga vota popullore e 6 tetorit 2019.

Kosovës i nevojitet një lidhshmëri të fortë, i vendosur dhe i guximshëm për të marrë vendime të shpejta, të drejta, të arsyeshme dhe të guximshme. Koalicioni LV-LDK gërsheton më së miri energjitë rinore dhe përvojën qeverisëse, prandaj shpresat ndaj tij janë të mëdha. Ruajtja e unitetit politik të koalicionit LV-LDK është kruciale për suksesin e lidhshmëritë të Kosovës. Ka dhe do të ketë përpjekje djallëzore të

brendshme dhe të jashtme për ta përçarë koalicionin LV-LDK dhe për të dobësuar kështu, deri në dështim suksesin e tij.

Kurti, Mustafa e Osmani dhe bashkëpunëtorët e tyre kanë përgjegjësi historike, ndaj duhet të qëndrojnë në lartësinë e kërkesave të kohës. Unitet, përgjegjësi dhe profesionalizëm - ja çfarë i duhet koalicionit LV-LDK të qeverisë Kurti. Përballë unitetit, përgjegjshmërisë dhe profesionalitetit askush, as nga brenda dhe as nga jashtë, as me presione dhe as me miklime nuk do të mund ta thejë lidhshmërinë e koalicionit LV-LDK dhe qeverinë Kurti.

2. Presidenti Thaçi jashtë binarëve kushtetues e legjitimitetit popullor

Për bipolarizimin e politikës së jashtme dhe diplomacisë së Kosovës përgjegjësi e veçantë dhe kryesore ka presidenti i Kosovës, Thaçi. I mësuar dhe i toleruar për një kohë të gjatë në krye të Presidencës së Kosovës dhe i mbështetur jashtë kompetencave kushtetuese nga mazhorancat e krahut të luftës, PAN, presidenti Thaçi, siç duket mediatikisht, po vazhdon sërish dhe, madje, intensivisht ta luajë protagonistin në politikën e jashtme dhe diplomacinë e Kosovës, sikur të jetë zgjedhur nga populli ose sikur gëzon të njëjtat kompetenca kushtetuese si homologu i tij serb, Vuçiq. Presidenti Thaçi duhet të futet në binarët kushtetues, nëse nuk e bën këtë vetë, atëherë duhet t'i imponojnë normat dhe institucionet kushtetuese të

Kosovës. Presidenti Thaçi nuk ka asnjë tagër kushtetues e pushtet legjitim për përgatitjen, elaborimin, udhëheqjen dhe implementimin e politikës së jashtme dhe diplomacisë së Kosovës. Presidenti Thaçi gjithashtu duhet ta ketë të qartë se ai nuk ka tagrin kushtetues dhe legjitimitetin e homologut të tij serb, Vuçiq, pushteti i të cilit buron nga Kushtetuta e Serbisë dhe vota e drejtpërdrejtë popullore.

3. ShBA-BE të bashkëpunojnë me lidhshmërinë kushtetues dhe legjitim të Kosovës

Për paradoks, ka disa faktorë ndërkombëtarë, në ShBA dhe BE, që po vazhdojnë të komunikojnë e veprojnë jo me lidhshmërinë kushtetues dhe legjitim të Kosovës, pra me qeverinë Kurti të koalicionit LV-LDK, por po i krijojnë qasje të padrejta, të paarsyeshme dhe krejtësisht të padobishme presidentit Thaçi për çështje substanciale të politikës së jashtme dhe diplomacisë së Kosovës.

Natyrisht, presidenti i Kosovës përfaqëson një institucion të veçantë kushtetues për Kosovën dhe, si i tillë, ai ushtron kompetenca edhe te marrëdhëniet ndërkombëtare, vetëm në protokollet dhe ceremoniale diplomatike në emër të shtetit të Kosovës. Gjithçka është sanksionuar saktë dhe qartë në Kushtetutën e Kosovës, ku parashikohet se politika e jashtme dhe diplomacia e Kosovës drejtohen nga Qeveria e Kosovës,

kryeministri, ministri i Jashtëm pasi miratohen dhe ratifikohen nga Kuvendi i Kosovës.

Është momenti, tanimë, që ShBA-ja dhe BE-ja, si dhe përfaqësuesit e tyre diplomatikë, ta fillojnë bashkëpunimin e tyre me institucionet kushtetuese, qeverinë e mazhorancën të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit 2019, për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Kosovën përgjithësisht dhe me politikën e jashtme dhe diplomacinë e saj në mënyrë të veçantë.

Kosova po përjeton një tensionim të brendshëm të panevojshëm, shkaku kryesor i të cilit ka të bëjë me bipolaritetin e politikës së jashtme dhe diplomacisë së Kosovës, përqendruar njëkohësisht te qeveria e re dhe te presidenti Thaçi. Ky bipolaritet antikushtetues dhe jo legjitim duhet të ndërpritet sa më shpejt aq më mirë, për të siguruar kështu konstitucionalitet dhe legjitimitet pushteti dhe institucionesh në Kosovë. Nëse ky bipolaritet do të thellohet, atëherë në vend të unitetit, politika e jashtme do të përçahet dhe, në vend të kohezionit social, vendi do futej në kaos. Më tepër se kurrë, Kosovës i nevojitet unitet dhe kohezion në koalicionin qeveritar dhe në rrafsh mbarëkombëtar, për përmbushjen me sukses të të gjithë politikave publike si dhe të dialogut me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve deri në njohjen reciproke.

Është koha që qeveria Kurti të bëjë hapa para, presidenti Thaçi të bëjë hapa prapa dhe ndërkombëtarët të ripozicionen në njohjen dhe bashkëpunimin me lidhshmërinë e ri kushtetues dhe legjitim të Kosovës.

Kamenica fton prindërit të marrin pjesë në takime për t'i paraqitur ankesat për procesin mësimor



KAMENICË, 9 MARS (ER) - Drejtoria Komunale e Arsimit në Kamenicë ka ftuar të gjithë prindërit, çdo të premte prej orës 16:00, që të marrin pjesë në takimet që organizohen në këtë komunë lidhur me vërejtjet e ankesat për subjektet e përfshira në procesin mësimor, të cilat si tërësi obligojnë DKA-në t'i trajtojë.

Ushtruesja e detyrës së drejtoreshës së Arsimit, Mirhane Morina-Bislimi, ka thënë se dhuna ndaj nxënësve, qoftë fizike apo psikologjike, është e patolerueshme, siç është edhe mësimdhënësia e papërgatitur

para fëmijëve tuaj e nxënësve tanë, e që e determinon të ardhmen tonë të përbashkët. Në këtë kontekst, Morina-Bislimi u ka bërë thirrje të gjithë prindërve që secilin rast, mangësi, kërkesë, ankesë apo vërejtje ta drejtojnë në këtë drejtori sepse, sipas saj, vetëm atëherë do ta kenë pasqyrën e vërtetë të ngjarjes dhe detyrën për ta gjetur mundësinë e zgjidhjes. "Ndër të tjera, për t'i paraqitur ankesat apo vërejtjet e juaja për procesin mësimor, mund të drejtoheni edhe në numrin e u. d. drejtoreshës +38345338132 ('Sms', 'Viber', 'Whatsapp')", ka thënë ajo.

Trupat amerikane kanë nisur të largohen nga Afganistani

UASHINGTON, 9 MARS - Një zyrtar amerikan ka thënë se forcat e Shteteve të Bashkuara kanë nisur të largohen nga Afganistani, siç parashihet me marrëveshjen e fundit të nënshkruar mes SHBA-së dhe talibanëve.

Ky zyrtar, që ka folur në kushte anonimiteti, i ka thënë agjencisë së lajmeve, Associated Press, se qindra ushtarë amerikanë tani janë duke u larguar nga

Afganistani.

Kjo nënkupton që Shtetet e Bashkuara do të nisin të zvogëlojnë praninë e tyre në Afganistan duke lënë 8,600 nga 13,000 trupa sa kanë tani. Plani afatgjatë për SHBA-në është që të tërheqë të gjithë trupat nga Afganistani brenda 14 muajve, nëse zbatohen të gjitha kushtet e sigurisë.

Mirëpo një mosmarrëveshje politike në mes të zyrtarëve afganë lidhur me zgjedhjet

presidenciale rrezikon t'i komplikojë tentimet e Uashingtonit për të zbatuar marrëveshjen me talibanët, në mënyrë që të përfundojë lufta 18-vjeçare e Afganistanit. Rivalët politikë në Afganistan, presidenti Ashraf Ghani dhe presidenti i vetëshpallur, Abdullah Abdullah, kanë zhvilluar ceremonitë e inaugurimit për president në kohën e njëjtë të hënën në Kabul.



Shtëpia e Bardhë, me një rrethojë të re e të fortë

Shërbimet sekrete amerikane si dhe Shërbimi i Parkut Kombëtar po punojnë për ta zëvendësuar rrethojën aktuale, pas një seri kërcënimesh ndaj sigurisë, përfshirë një incident në vitin 2014 kur një person kaloi pa leje rrethojën dhe iu afrua Shtëpisë së Bardhë

UASHINGTON, 9 MARS - Presidenti Trump më në fund do të ketë një rrethojë më të madhe, më të fortë, jo përgjatë kufirit jugor të vendit me Meksikën, por përreth oborrit të Shtëpisë së Bardhë. Shërbimet Sekrete amerikane si dhe Shërbimi i Parkut Kombëtar po punojnë për ta zëvendësuar rrethojën aktuale, pas një seri kërcënimesh ndaj sigurisë, përfshirë një incident në vitin 2014 kur një person kaloi pa leje rrethojën dhe iu afrua Shtëpisë së Bardhë.

Një nga objektet më të fotografuara në Uashington është bllokuar pjesërisht nga ky instalim, pjesë e një gardhi të ri që do ta rrethojë Shtëpinë e Bardhë. Pjesa e parë e tij është tashmë gati. Ai është rreth katër metra i lartë ose pothuajse dyfishi i lartësisë së gardhit të vjetër. Gjithashtu, është më i trashë e më i fortë. Në gardhin e ri po vendosen pajisje me teknologji kundër ngjitjes dhe që ndalon çdo hyrje të paligjshme, ka

njoftuar "voa". "Ky dyfishim i lartësisë së gardhit garanton një lloj mbrojtjeje nga shpërthimet dhe goditjet. Gjithçka, të gjitha pjesët, duhet të forcohen", thotë Thomas Luebke, i Komisionit Amerikan të Arteve të Bukura.

Gardhi i parë që rrethonte Shtëpinë e Bardhë, një gardh prej druri, u vendos gjatë kohës së Thomas Jeffersonit në fillim të viteve 1800. Me kalimin e viteve, gardhet u bënë prej guri e hekuri. Por ato nuk kishin për qëllim që t'i mbanin njerëzit jashtë. Vizitorët shpesh lëviznin lirisht në oborrin e Shtëpisë së Bardhë. "Ishte relativisht e lehtë të futeshe brenda dhe të ngjiteshe lart në katin e dytë. Atje punonte presidenti para se të ndërtohej ai që njihet si West Wing (Krahu Perëndimor i Shtëpisë së Bardhë). Imagjinoni presidentin duke u përpjekur ta përfundojë punën ndërsa rrethohet nga ata që kërkojnë një pozicion aty, lobistët, pra të gjithë llojet e njerëzve që në thelb dilnin në korridor, me



shpresën për të siguruar një takim të shpejtë me presidentin apo qoftë për ta parë atë", thotë Matthew Costello, i Shoqatës së Historianëve të Shtëpisë së Bardhë.

Në vitet 1920 presidentët vendosën se deri ku mund të qasej publiku në oborrin e Shtëpisë së Bardhë. Përfundimisht kontrolli mbi sigurinë u la në duart e shërbimeve sekrete pas vrasjes së tre presidentëve gjatë një periudhe 36-vjeçare mes viteve 1865 dhe 1901. "Bëhet fjalë për vrasjen e Abraham Lincolnit, James Garfieldit dhe William McKinley. Nëse do të kishit

lindur në vitin 1840, do të kishit qenë dëshmitarë në tri atentate ndaj presidentëve", tha ai.

Komisioni i Arteve të Bukura ka punuar për të siguruar një ekuilibër mes përmirësimit të kushteve të sigurisë që garanton gardhi i ri, me ruajtjen e një pamjeje vizualisht tërheqëse. "Nuk është çështja për ta marrë modelin e vjetër dhe thjesht ta dyfishosh. Duhet menduar se me çfarë materiali janë bërë pjesët dhe si mund të funksionojnë më mirë së bashku. Duke u përpjekur për ta ngritur me përmasat e duhura, duhet të vendosim njëkohësisht se cili material është i duhuri për secilën pjesë apo

çfarë veshje duhet të ketë", thotë Thomas Luebke, i Komisionit Amerikan të Arteve të Bukura.

Punimet për ndërtimin e gardhit pritet të përfundojë në 2021. Deri atëherë vëmendja mund të kthehet te një projekt gjithëpërfshirës për pjesën tjetër të kompleksit të Shtëpisë së Bardhë, një plan që duhet të marrë në konsideratë sigurinë dhe estetikën. "Në këtë mënyrë ata mund të krijojnë diçka që duhet, e që tani është pak si mishmash", thotë Thomas Luebke.

Një instalim për mbrojtje, por që nuk shkatërron pamjet më ikonike të Uashingtonit.

Mijëra migrantë përpiqen të kalojnë nga Turqia drejt Evropës

BERLIN, 9 MARS - Gjermania tha të hënën se Bashkimi Evropian po shqyrton mundësinë për të pranuar deri në 1.500 fëmijë imigrantë të strehuar aktualisht në kampet greke. "Ne duam ta mbështesim Greqinë në situatën e vështirë humanitare", njoftoi qeveria. Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan është takuar ndërkohë në Bruksel me zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian për të diskutuar mbi fluksin e madh të migrantëve në Turqi të cilët po përpiqen të kalojnë drejt vendeve të Bashkimit Evropian.

Mijëra refugjatë kanë mbërrit-

ur përmes tokës dhe detit në kufirin lindor të Turqisë. Prej një jave ata kanë ngritur kampe përgjatë vijës kufitare me Greqinë me shpresën për të kaluar në atë vend dhe përfundimisht drejt vendeve të tjera të Evropës Perëndimore. Athina tha të hënën se gjatë 24 orëve të fundit ka ndaluar hyrjen në territorin e saj nga Turqia të më shumë se 1,500 migrantëve.

Në orët e hershme të mëngjesit të së hënës, migrantët përdorën gomone për të kaluar nga Turqia në Greqi përmes lumit Evros. Një i ri nga Afganistani i tha agjencisë së lajmeve Associated Press se

kjo ishte përpjekja e tij e dytë për të kaluar lumin. Ai tha se ishte kapur dy ditë më parë nga rojat greke dhe ishte detyruar të kthehej mbrapsht me not në temperatura e ulëta dimërore.

Në fillim të muajit, qeveria e presidentit Rexhep Tajip Erdogan njoftoi se nuk do t'i ndalonte më migrantët dhe refugjatët që të kalonin drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan reagoi me ashpërsi për situatën. "A nuk janë gratë dhe fëmijët që po vuajnë më shumë mes refugjatëve të dyndur në kufijtë detarë dhe tokësorë me



shpresën për të shkuar në Evropë? Në fakt, a nuk janë gratë dhe fëmijët që po luftojnë drejtpërdrejt me vdekjen në ato gomone që po shtyhen nga ushtarët grekë dhe të lënë

mes valëve të egra të Egjeut? Çfarë po bën Perëndimi për këtë dhe a po shpreh shqetësim? Ata nuk po ngrenë zërin për këtë problem", tha Erdogan.

JO VOTEN SHQIPTARE MAQEDONIT

Sokol GASHI

Po afrohen zgjedhjet e prillit 2020 në Maqedoninë e Veriut! Sikur zgjedhjet e kaluara edhe këto zgjedhje janë me interes të gjithanshëm! Kryetari i LSDM-së Zaev u bë i pari që pas vitit 2001, arriti të merrte votë shqiptare dhe këtë fitore të parë të tijë, në zgjedhjet e prillit është duke tentuar ta thellojë edhe më shumë, ta ketë edhe me të madhe! A duhet të ndodhe në mes shqiptareve kjo? A bën të ndodhë në mes të shqiptareve kjo? Vëllezër e motra shqiptare, të përkatësisë fetare muslimane, ortodokse e shqiptare në Maqedoninë e Veriut, pashë gjakun shqiptar në deje që e keni! Pashë varret e gjyshërve e stërgjyshërve, nënave e lokeve tona heroina e të shumëvujtura! Pashë luftën shqiptare e gjakun e derdhur të luftëtarëve për liri nëpër histori e të luftës së vitit 2001 të UÇK-së në Maqedoninë e Veriut!

Pashë Dëshmorët e Heronjtë e Kombit, të plagosurit në luftë dhe invalidët e çlirimit të Atdheut! MOS JA JEP VOTEN TËNDE KANDIDATIT MAQEDON PËR DEPUTET! MOS JA JEP VOTEN TËNDE PARTISË POLITIKE MAQEDONE! Mos ja jep voten shqiptare maqedonit, se voten tënde shqiptare mundesh me ia dhënë kandidatit nga partia politike shqiptare! Ti qe e din historinë e popullit shqiptar, si mundesh me ia dhënë votën tënde kandidatit e partisë politike maqedone? A do të hahet buka e a do të pihet uji pasi ta votosh kandidatit e partinë politike maqedone? Po do të hashë e do të pishë, por do të jetosh me turp e me faqe të zezë! Ndërgjegjja nëse ke ka për të vrarë përgjithmonë! Femijët, nipërit e mbesat tuaja kur të mësojnë për këtë votën tende për maqedonin e jo shqiptarin, do të të pështyejnë mbi varr, do të turpërohen përgjithmonë! A ke harruar se çka kanë bërë

maqedonët në kohën e ish-jugosllavisë dhe pas demokracisë së viteve të 90-ta mbi popullin shqiptar në Maqedoninë e Veriut a? Të dashur dhe shumë të nderuar kryefamiljarë të familjes shqiptare në Maqedoninë e Veriut! Pashë të ardhmen e ndritur e të lumtur të fëmijëve tuaj, nipërve e mbesave, votoni kandidatët shqiptar për deputet dhe partite politike shqiptare! Qysh mundesh kur ta marrësh lapsin e votu, dhe voton për kandidatit e partinë politike maqedone, dhe aty ke kandidat shqiptar dhe parti politike shqiptare!... Votues shqiptar në Maqedoninë e Veriut, të lutem, pashë buken e pashë ujin, pashë token e pashë varret e të parëve tanë, pashë varret e dëshmorëve të Atdheut e pashë varret e veprimtareve të kombit, pashë varret mesuesve e profesoreve shqiptare, mos voto për kandidatit maqedon e për partinë politike maqedone! Nëse e ndjen veten tënde votë të mirfillët shqiptare, mos lejo të votosh për LSDM e VMRO! O vëlla shqiptar!

Oj moter shqiptare! Jo, mos voto kandidat maqedon e parti politike maqedone! Jo është mekat! Është marre! Nuk duhet dhe nuk ban që vota shqiptare të shkojë, për ata të parët e të cilëve, na kanë shtypur e na kanë mbajtur robër të tyre, për ata që në vitin 2001 të luftës çlirimtare, ishin kundër çdo gjëje shqiptare! Jo votën shqiptare për maqedonët, se të mallkon toka e të mallkon lokja, të mallkon gjaku e të mallkon Kombi, të mallkon Skënderbeu e të mallkon Atdheu! Popull shqiptar i Maqedonisë së Veriut, voto për kandidat shqiptar e për parti politike shqiptare! Popull shqiptar i Maqedonisë së Veriut, voto shqip e për parti politike shqipe! Shqiptarët e Maqedonisë, voten vetëm partive shqiptare, askujt tjetër! Vota e shqiptarit në Maqedoninë e Veriut, të shkojë për popullin shqiptar! Kush voton për kandidatit shqiptar e për partinë politike shqiptare në Maqedoni, ka

votuar jo vetëm për veten e tij, për fëmijët e tij, për nipër e për mbesa, por ka votuar edhe për SHBA, edhe për NATO, edhe për BE, edhe ka votuar për të ardhmen e lirë e origjinale shqiptare! Voto shqip e shqiptarisht, e jo maqedonisht! Shqiptarë nëse votoni shqip, do te vazhdoni të keni Kryetar shqiptar të Parlamentit, Zv. Kryeministra, shumë Ministra e zv. Ministra, Drejtorë e Zv. Drejtorë, në të kundërtën shqiptarët do bëhn të mjerë, e do të humbin fuqinë politike dhe ekzekutive ne Maqedoninë e Veriut! Jo maqedonisht, por shqip voto! Shqip për flamur e për gjuhën shqipe, për integrim euroatlantik e për emancipim njerëzor! E ardhmja e Maqedonisë së Veriut, është 50% shqiptare! Me votën tonë duhet ta rrisim këtë përqindje! Rroftë populli shqiptar në Maqedoninë e Veriut!

8 Mars 2020!




E jashtëzakonshme

Në Japoni bie shi me ngjyrë të zezë

Pas publikimit të lajmit se ka rënë shi me ngjyrë të zezë në disa pjesë të Japonisë, menjëherë kanë filluar të qarkullojnë teoritë ndryshme lidhur me këtë, duke filluar nga mbetet bërthamore, ndotja e ajrit e

deri te koronavirusi. Autoritetet e disa qyteteve ishin "bombarduar" me fotografi nga qytetarët që u kishin dërguar pamje kur binte shi me



ngjyrë të zezë, në veçanti në prefekturën e Saitamas.

FOTO E DITES



Ushtarët në Korenë e Jugut shihen të veshur me kostume mbrojtëse derisa dezinfektojnë rrugët në Suel për t'u mbrojtur nga koronavirusi. /AP/

E rrallë

Vajza lind me katër këmbë dhe tri duar

Një foshnjë ka lindur me katër këmbë e tri duar. Ngjarja ka ndodhur në Rajasthan të Indisë. Një grua indiane shtatzënë ka lindur dy foshnja, njëra prej së cilës ishte vajza në fjalë, që ka pësuar mutacion. Vajza, si pasojë e një mutacioni, ka lindur me këmbë e duar shtesë.



BARSOLETA E DITËS



Dy shoqe takohen me njëra-tjetrën dhe njëra, tepër entuziaste, i thotë tjetrës:
- Ua, më në fund, pas tre vjetësh që jemi bashkë, Gimi më foli për fëmijë!
- Me të vërtetë? - i përgjigjet shoqja. Po çfarë të tha konkretisht, të bëri ndonjë propozim, apo çfarë?
- Jo. Më tha që e shoqja quhet Moza, i tregon ajo, dhe që kanë dy fëmijë, është në pritje të të tretit.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00
Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno

Në ora 18:00
Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00

STAR WARS; THE
RISE OF
SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30

THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info**, **www.kinoabc.info**, **fb: Kino ABC**.



DASHI
Disa shqetësime për shëndetin e një gjyshi, por nuk ka nevojë të emocionoheni, nën temperamentin e tij ai është më i fortë se i juaj.



DEMI
Ju do të jeni shumë aktiv dhe i vendosur, keni energji, vendosmëri dhe iniciativë për çdo gjë, prandaj, dita e zënë nuk do t'ju trembë aspak.



BINJAKËT
Nëse ka pasur një largim midis të afërmeve, ka ardhur koha për ta zgjidhur çështjen dhe mosmarrëveshjet përpara një tryeze të shtruar.



GAFORRJA
Partneri juaj do të jetë më shumë se kurrë luftues dhe xheloz. Sa për çështje praktike, ngadalë arrini atë që dëshironi.



LUANI
Do të keni pak fjalë dhe pak ide. Shpenzimet pritet të jenë të forta, madje as kërkesat për para nga vëllai juaj ose një miku nuk përjashtohen.



VIRGJËRËSHA
Marrëdhëniet shoqërore janë në rënje, por nuk është e përshtatshme për ju të mbyllni veten në shtëpi.



PESHORJA
Përfitoni nga stimujt që mund të mblidhni nga një kontakt i ri, do t'ju ofrojë ide dhe mjete të dobishme për ta theksuar veten.



AKREPI
Hëna në Luan ndodhet kundër jush. Rezultati? Ju ndihen i hutuar, me moral në tokë, shihni gjithçka të zezë.




SHIGJETARI
Kalimi i Hënës në Luan, përveç rimbushjes së baterive tuaja, e kanalizon tepriçën e energjisë në veprime të shpejta.



BRICJAPI
Thirrja e së kaluarës është e fortë! Janë kujtime që nuk do ta ngrohni shumë zemrën tënde.



UJORI
Gjërat nuk shkojnë mirë si në këtë ditë. Një takim i humbur ose një ngjarje e papritur që mund t'ju çojë në befasi.



PESHQIT
Do të jeni më të hapur, dinamik dhe komunikues sesa zakonisht, dhe kjo do ta rrisë shumë vlerësimin tuaj në fushën sociale.

Meghan Markle surprizon nxënësit në Londër



Dukesha e Sussex befasoi një shkollë të tërë me nxënës për ta shënuar Ditën Ndërkombëtare të Grave, megjithëse ajo nuk e kuptoi se vizita e saj ishte e papritur. Meghan Markle takoi studentët në Dagenham në lindje të Londrës. Kishte shumë ulërime,

brohoritje nga nxënësit gjatë kësaj vizite dhe, po ashtu, disa komente me spec për Dukeshën që, ndoshta, mund t'i kenë bërë përshtypje. Kjo ishte një nga paraqitjet e saj të fundit zyrtare përpara se ajo dhe burri i saj Princi Harry do të tërhiqen nga detyrat mbretërore më 31 mars.

Celine Dion shfaqet plot stil



Ajo është një nga këngëtares më të njohura në botë. Celine Dion është mjaft e guximshme edhe

në stilin e veshjes. Këngëtarja 51-vjeçare, pavarësisht moshës, është shfaqur plot stil me një palë kostume ngjyrë rozë.




Rita Ora më 13 mars lanson këngën e re

Këngëtarja me famë botërore Rita Ora më 13 mars do ta publikojë këngën e saj të re. Kështu ka

paralajmëruar artistja me origjinë shqiptare në llogarinë e saj në "Facebook".

Vdes në moshën 90-vjeçare aktori Max Von Sydow



Aktori Max Von Sydow, i cili u shfaq në filma dhe seriale televizive duke përfshirë "The Exorcist", "Flash Gordon" dhe "Game of Thrones", ka vdekur të dielën në moshën 90-vjeçare. Lajmin e ka bërë me dije familja e tij. Ai u nominua për

dy oskarë gjatë karrierës së tij, përfshirë atë për aktorin më të mirë më 1998 për "Pelle The Conqueror". Kohët e fundit ai u shfaq në Extremely Loud & Incredibly Close (2011), Star Wars: "The Force Awakens" (2015) dhe në "Game of Thrones".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Flamurtari ndali Ballkanin, Tovërlani debuton me fitore

Ballkani nuk e ka shfrytëzuar dështimin e Prishtinës dhe Gjilanit për ta shtuar dallimin e pikëve, pasi humbi përballjen me Flamurtarin. Afrim Tovërlani debutoi me fitore si trajner i Feronikelit, kurse Drenica realizoi fitore të rëndësishme në garën për mbijetesë



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 MARS - Lideri i IPKO Superligës në futboll, Ballkani, ka pësuar humbje të papritur në kryeqytet nga Flamurtari (2-1). Skuadra e Ismet Munishit, pas formës së lartë në këtë edicion garash, barazimit me Prishtinën dhe fitores ndaj Dritës në ndeshjen e fundit, përballë Flamurtarit u konsiderua favorit absolut, por në fund doli duarthatë nga ndeshja në kryeqytet.

Në minutën e 21-të Bashkim Shala e shënoi golin e parë, kurse Mirlind Daku e barazoi rezultatin në fund të pjesës së parë, goli nuk u pranua për shkak të pozitës jashtë lojës. Në fillim të pjesës së dytë kuqezinjtë shënuan edhe një herë në portën e Ballkanit, kësaj radhe golashënues ishte Veton Kabashi. Në minutat në vazhdim mysafirët dominuan, kurse Daku shënon edhe një herë nga pozita jashtë lojës. Megjithatë, Daku nuk u dorëzua dhe arriti të shënojë për rezultatin final 2-1. Pas kësaj xhiroje Ballkani vazhdon të jetë lider me 44 pikë, kurse Flamurtari ngritët në pozitën e tetë me 28 pikë. Ashtu siç ishte pritur, Feronikeli ka shënuar fitore në ndeshjen kundër Vushtrrisë (2-0). "Kam pritur që të jetë një fushë më e rënduar, por ishte në gjendje që të luhet futboll. Duke ditur se Flamurtari lufton për mbijetesë, gabuam në dy ndërprerje të cilat i

kemi stërvitur. Ne vijmë pas dy super sfidave, gjithsesi tentuam me një gol rikthimin tonë, por pak ishin edhe rrethanat, duke mos komentuar edhe referimin. Faza e tretë? Do të jetë përparësi e madhe të luajmë si vendës lojën e fundit të kampionatit, pasi si mysafirë kemi pasur rrethana të çuditshme", ka thënë pas ndeshjes Ismet Munishi, trajner i Ballkanit.

Ndërsa trajneri i Flamurtarit, Sunaj Keçi, pas ndeshjes deklaroi: "Ishte një ndeshje mjaft e rëndësishme për ne. Na janë nevojitur shumë tri pikët. Kemi punuar më shumë në anën psikologjike në ditët e fundit pas humbjes nga Drenica. E mundëm një kundërshtar që e synon titullin e kampionit dhe Kupën e Kosovës. Djelmoshat treguan karakter dhe treguan që mund t'i mposhtin të gjitha ekipet, pa marrë parasysh a është Ballkani, Prishtina, apo dikush tjetër". Trajneri Afrim Tovërlani e nisi në mënyrë më të mirë punën në skuadrën nga Drenasi. Kampionët në fuqi të Superligës e nisën më mirë ndeshjen dhe dominuan deri në minutën e 18, kur Ilir Berisha realizoi për 1-0. Pjesa e parë u mbyll me këtë rezultat, kurse në pjesën e dytë "Nikli" shënoi edhe golin e dytë në minutën e 67. Autor i golit ishte Mevlan Zeka. Mendurim Hoti pati mundësinë që ta trefishojë epërsinë, por nuk u tregua i saktë nga pika e bardhë. Pas kësaj ndeshje, Feronikeli

është në pozitën e gjashtë me 34 pikë, kurse Vushtrria mbetet e parafundit me 16 pikë. Skuadra e Dukagjinit ka regjistruar edhe një rezultat jo të mirë në elitë, pasi është mposhtur nga Drenica (1-3). Klubi nga Klina e nisi mirë ndeshjen dhe pas trembëdhjetë minutave lojë realizoi nëpërmjet Granit Arifajt. Gjashtë minuta më vonë shifrat në 1-1 i barazoi Flamur Muleci. Në minutën e 41-të, Argjend Mustafa e kaloi ekipin kuqezin në epërsi 1-2. Mustafa e shënoi edhe golin e tretë në pjesën e dytë për rezultatin përfundimtar 1-3. Tash Drenica ka grumbulluar 31 pikë dhe zë vendin e shtatë, kurse Dukagjini vazhdon të jetë i fundit me vetëm 10 pikë.

IPKO SUPERLIGA - Java 22

Flamurtari - Ballkani	2-1
Dukagjini - Drenica	1-3
Feronikeli - Vushtrria	2-0
Drita - Prishtina	2-1
Llapi - Gjilani	2-1
Ferizaj - Trepça '89	4-0

Tabela

1. Ballkani	22	44 pikë
2. Drita	22	43
3. Gjilani	22	41
4. Prishtina	22	41
5. Feronikeli	22	34
6. Llapi	22	34
7. Drenica	22	30
8. Flamurtari	22	28
9. Trepça '89	22	26
10. Ferizaj	22	25
11. Vushtrria	22	16
12. Dukagjini	22	10

SHKURT

Berisha, MVP i javës së 27

Basketbollisti i Pejës, Dardan Berisha, është zgjedhur MVP i javës së 27 në Superligën e Kosovës në basketboll. Peja mundi Rahovecin me rezultat 89:70 në derbin e kësaj jave, kurse lojtari më i dalluar ishte Dardan Berisha. Ylli i Kosovës ishte basketbollisti më i dalluar me 27 pikë, katër kërcime dhe gjashtë asistime, me një efektshmëri prej 29. Berisha është një nga lojtarët kyç të Pejës, duke e ndihmuar skuadrën pejane ta fitojë Kupën e Kosovës. Ndërkohë, top pesë shënuesit e kësaj jave janë: Dayon Griffin i Feronikelit me 31 pikë, Tamas Bruce me 29, Dardan Berisha me 27, Darell Davis me 24 dhe Valon Bunjaku.

Southamptoni dhe Leipzigu i shtohen garës për Rashicën

Milot Rashica pritet të largohet nga skuadra e Werder Bremenit. Klubi gjerman është drejt rënies në Bundesliga 2 dhe Rashica pritet të largohet, pasi ofertat për të nuk mungojnë. Liverpools, Crystal Palace, Newcastle Unitedi, Benfica e Borussia Dortmundi kanë qenë skuadrat e interesuara për yllin nga Kosova. Por së fundmi në garë për t'i fituar shërbimet e reprezentuesit të Kosovës janë futur edhe dy skuadra të tjera. Bëhet fjalë për Southamptonin dhe Red Bull Leipzigin, kurse 23-vjeçari ka një klauzolë largimi prej 38 milionë eurove.

Shqipëria përballlet me Slloveninë në Koper

Koronavirusi ka bërë që të preket edhe bota e sportit. Pas ndeshjeve pa tifozë në Itali, anulimit të kampionatit në Zvicër, në pikëpyetje u vendosën edhe miqësoret e Kombëtares së Shqipërisë të planifikuara në fund të këtij muaji. Rastet e para pozitive me koronavirus në vendin tonë kanë sjellë anulimin e ndeshjes kundër San Marinos, teksa takimi nuk mund të luhet as në mikroshtetin që ndodhet në Itali e as në Shqipëri. Por i njëjti skenar nuk vlen për miqësoren me Slloveninë. Ndeshja me këta të fundit është vendosur që të luhet, me ndryshimin e vetëm të stadiumit dhe shtetit. I planifikuar fillimisht për t'u luajtur në Udine të Italisë, takimi me përfaqësuesen sllovene do të zhvillohet në Koper, më datë 30 mars në orën 20:45. Lajmi konfirmohet nga vetë Federata e Futbollit të Sllovenisë.

Broja: Kam ëndërruar të debutoj për Chelsean

Sulmuesi i ri shqiptar Armando Broja ka thënë se i është realizuar një ëndërr me debutimin me fanellë të Chelseat. Broja 18-vjeçar u aktivizua të dielën nga minuta e 86 në vend të Olivier Giroudit në fitore 4-0 të Chelseat në shtëpi ndaj Evertonit. "Është ndjenjë e jashtëzakonshme. Unë kam qenë këtu që nga fëmijëria dhe kam ëndërruar për këtë moment gjatë gjithë kohës. Ta bëj debutimin në 'Stamford Bridge' ishte edhe më bukur", ka thënë Broja për "Sky Sports". Broja është pjesë e U21 të Shqipërisë. "Para se të inkuadrohesha isha pak nervoz, por fola me trajnerin dhe ai më tha ta shijoj veten. Kështu që kam shijuar minutat që luajta dhe ishte ndjenjë e jashtëzakonshme", ka vazhduar Broja. "Premierë Liga është ashtu, është ndoshta liga më e fortë në botë. Por, unë e pashë atë të vinte dhe thjesht bëra një prekje e ai më goditi. Ishte mirë, pasi fitova një gjuajtje të lirë në pozitë të mirë", ka shtuar Broja.

Ministrja Dumoshi: Vajzat e Kosovës po thyjnë tabutë në sport

PRISHTINË, 9 MARS - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka marrë pjesë në Forumin e parë për Vajzat Lidere në Sport, i cili u mbajt në kuadër të festës së 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas, aktivitet të cilin e organizoi Komiteti Olimpik i Kosovës.

Ministrja e vlerësoi organizimin të rëndësishëm të veçantë për faktin se shënohet me një datë të rëndësishme dhe aktiviteti ka një temë që është jetike sepse me avancimin e vajzave në sport, edhe sporti në Kosovë ka një cilësi e suksese edhe më të mëdha. “Vajzat në Kosovë kanë

rol të rëndësishëm në sport. Unë si ministre do të jem e suksesshme vetëm falë bashkëpunimit të ngushtë që do ta kemi, si dhe për mbështetjen e klubeve, sepse është bërë një farë dallimi mes klubeve të meshkujve dhe femrave. Kosovën do ta qesim në

planin e parë të sportit dhe rinisë. Ky është vit olimpik dhe Kosova në Lojërat Olimpike Tokio 2020, do të përfaqësohet me shumë femra”, ka thënë ministrja Dumoshi, e cila ka përmendur edhe infrastrukturën sportive si njërin nga prioritetet e MKRS-së.



Tottenhami kërkon përmbysjen ndaj Leipzigut

LEIPZIG, 9 MARS - Tottenham Hotspur do të përballet me RB Leipzig në Ligën e Kampionëve të martën në kërkim që ta përmbysë epërsinë e ndeshjes së parë të zhvilluar në Angli. Nënkampionët e Evropës e humbën ndeshjen e parë me rezultat 0-1, kurse nga penalltia kishte shënuar Timo Werner. Skuadra gjermane, Leipzig, nuk konsiderohet ndër favoritët për ta fituar Ligën e Kampionëve këtë sezon, por gjigantët e Bundesligës duhet të merren seriozisht në këtë garë. Kjo skuadër renditet e treta në Bundesligë me 50 pikë nga 25 ndeshjet e zhvilluara, kurse është e pamposhtur në gjashtë ndeshjet e fundit në të gjitha garat. Tottenham, ndryshe nga edicioni i kaluar, nuk është në formën maksimale, por në këtë ndeshje synon fitoren dhe kualifikimin në çerekfinale. Klubi gjerman nuk



mund të llogarisë në shërbimet e Ibrahim Konate dhe Kevin Kampl, derisa “Spurs”, siç dihet, do të jetë pa dy sulmuesit Harry Kane dhe Son Heung-Min. Ndërsa në ndeshjen tjetër Atalanta i shkon në Spanjë Valencias me qëllim që ta ruajë rezultatin e thellë të ndeshjes së parë (4-1). Valencia do të

provojë më të gjitha forcat që ta përmbysë këtë epërsi, por për të arritur një gjë të tillë nuk do të jetë aspak lehtë. Të dy ndeshjet zhvillohen nga ora 21:00.

TË MARTËN TAKOHEN:		
21:00 Leipzig - Tottenham	(1-0)	
21:00 Valencia - Atalanta	(4-1)	

Fitojnë Phoenixi dhe Toronto, humbin Dallasi dhe Houstoni

Houston, 9 mars - Skuadra e Phoenixit ka fituar 140-131 ndaj Milwaukeees, në një ndeshje spektakolare mes dy ekipeve. Vendësit dominuan gjatë gjithë kohës në ndeshje, duke u shkëputur deri në 25 pikë (Booker 36 pikë), ndërkohë që te miqtë u ndje mungesa e Antetokounmpos (shënuesi më i mirë për Bucks ishte Middleton me 39 pikë). Fitore të vështirë arriti skuadra kampione e Torontos, që mundi 118-113 Sacramenton, ndeshje me rivalitet. Të gjithë titullarët e ekipit kanadez realizuan mbi 10 pikë, me dyshen Powell-Lowry që së bashku realizuan 61 pikë. Pas kohës shtesë fiton skuadra e Clevelandit, që mposhti me rezultat 132-129 San Antonion. Të dyja ekipet luftuan fort për fitoren, me 7 lojtarë të Cavaliersit që realizuan mbi 10 pikë



(Drummond 28 pikë e 17 rebounde). Në ndeshjet e tjera të luajtura, skuadra e Indianas triumfoi me rezultat 112-109 ndaj

Dallasit (Sabonis 20 pikë e 17 rebounde), ndërsa Orlando fitoi 126-106 ndaj Houstonit (Augustin 24 pikë).

REZULTATET	
Dallas - Indiana	109-112
Houston - Orlando	106-126
Cleveland - San Antonio	132-129
New York - Detroit	96-84
Sacramento - Toronto	113-118
Phoenix - Milwaukee	140-131

SHKURT

Conte: Interi ende nuk është në nivelin e Juventusit

Interi pësoi humbje nga Juventusit (2-0), kurse trajneri Antonio Conte mendon se skuadra e tij ende nuk është në nivelin e Juventusit. “Mendoj se ishte një sfidë shumë e ekuilibruar. Pjesën e dytë e nisëm më mirë ne. Ishim në kontroll të situatës, më pas goli i Aaron Ramseyt ndryshoi ndeshjen në nivel psikologjik: më pas ata u rritën, ne e vuajtëm shumë rrjetën pa arritur të ringriheshim. Kjo është përmbledhja”, ka thënë Conte. “Përtej rikuperimit kemi një diferencë prej 6 pikësh nga Juventusit: dy humbjet kundër tyre. Këta janë treguesit: jemi treguar të zotë që i kemi qëndruar në vijë, por është e pashmangshme të bëhen disa konsiderata. Duhet të tregohemi pozitivë dhe t’i nxjerrim aspektet e duhura. Edhe në rast humbesh mund të bësh disa analiza që mund të të ndihmojnë të rritesh në disa pikëpamje, si përvoja, personaliteti dhe cilësia. Kjo humbje duhet të na bëjë të kuptojmë se sa larg jemi, pa u dëshpëruar. Dy përballjet me ta i kemi humbur, rezultati flet qartë”, ka shtuar Conte.

Zidane: Ndeshja ndaj Betisit ishte më e dobëta këtë sezon

Zinedine Zidane merr përgjegjësitë për humbjen që pësoi Reali i Madridit në ndeshjen me Betisin. Trajneri francez e konsideron këtë ndeshje si më të dobëtën e këtij sezoni. “Është një ndeshje që e humbëm vetë. Luajtëm shumë keq si në të parën ashtu edhe në të dytën. Bëmë shumë gabime dhe e humbëm topin shpeshherë. Kjo ishte ndeshja më e shëmtuar e sezonit. Na mungoi gjithçka, energjia, loja, zotërimi i topit, intensiteti. Në një ditë negative mund të ndodhin shumë gjëra. Përgjegjësi për këtë jam unë. Nuk duhet ta bëjmë çmenduri këtë gjë, por sigurisht se nuk duhet të jemi të kënaqur. S’është normale që të bëjmë një ndeshje të tillë. Nuk u futëm kurrë në ndeshje. Mund të luash keq 45 minutat e para, por jo gjithë lojën. Nuk meritoni rezultat tjetër përveç humbjes. Duhet të punojmë. Jemi të gjithë bashkë në këto çaste dhe për këtë nuk ka dyshim”, ka thënë Zidane.

PSG-ja pa Mbappen kundër Dortmundit

Përballja e dytë mes PSG-së dhe Borussia Dortmundit do të zhvillohet në kryeqytetin francez dhe do të luhet me dyer të mbyllura, masë kjo për parandalimin e coronavirusit. Sikur të mos mjaftonte mungesa e tifozëve, tashmë francezët kanë edhe një problem tjetër. Sulmuesi Kylian Mbappe nuk është stërvitur ditën e hënë me ekipin dhe me shumë mundësi 20-vjeçari nuk mund të luajë ditën e mërkurë. Kampioni i Botës është në gjendje gripale dhe nuk ka mundur të marrë pjesë në seancën stërvitore. Vendimi përfundimtar nëse ai do të jetë apo jo i grumbulluar do të merret ditën të martën.

Nuk zhvillohet Indian Wells, shkak Coronavirusi

Coronavirusi ndal edhe tenis. Organizatorët e Indian Wellsit kanë zyrtarizuar moszhvillimin e Mastersit të parë të vitit pas zbulimit të një rasti me Covid-19 në Coachella Valley, ku ndodhet impianti me të cilin ishin parashikuar të zhvilloheshin ndeshjen e turneut, duke nisur nga 12 marsi. “Jemi të keqardhur, sepse turneu nuk do të zhvillohet. Por shëndeti dhe siguria e komunitetit lokal, tifozëve, lojtarëve, vullnetarëve, sponsorëve, të punësuarve dhe e të gjithë atyre që janë të përfshirë në këtë ngjarje janë shumë të rëndësishëm”, ka deklaruar докторi David Agus, profesor i Mjekësisë dhe i Inxhinierisë Biomjekësore në Universitetin e Kalifornisë së Jugut. “Për momentin, ekziston rreziku i madh për shëndetin publik në kontenë e Riverside nëse bëhen grumbullime të këtyre përmasave”, ka shtuar David Agus.

Autor: Gazmend Morina - BENI	LOKAL NATE ME PROGRAM ARTISTIK E ME MUZIKË	KIK-BOKSIERI SHQIPTAR MAKSUTAJ (shq.)	↓	AVULL QË DEL NGA TOKA ZBRITJA E AVIONIT NË TOKË	ARIANITI (perkdh.)	ZANORE	ZAIRI, ANGOLA	EPOKA ERE	LLOJ SHEQER- KE (sh.shq.)	KËNGËTARJA E FAMSHME AMERIKANE BAKER	ZENDEN AGUERO	KAMPIONI (sport)	BASHKËTING- ËLLORE	EMËR FEMRE MYSLIMANE	TINARI (krah.)	GAZ I PANGJY- RË, ME ERË TË DOBËT DHE HELMUES	PUSULLA
ENË QELQI E RRUMBULLAK- ËT SI SHISHE, PO ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK								BURGJET KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA DHE TË GJATA ANALISTI MUSTAFA									
GAZI QË PËR- BËN PJESËN MË MADHE TË AJRIT						BIMË E VISEVE TROPIKALE PËRSHTATJE (sh.shq.)							LEGJENDA KAFSHË E MADHE SHTËPIAKE				
REVOLVER I VOGËL I PRODHIMIT ITALIAN							TRAJNERI HOLANDEZ ... HAN KËNGËTARJA SHQIPTARE MIMANI				QË KA TË BËJË ME PARAARDHË- SIT TANË HIT NGA ARDIT GJE- BREA						
MUZIKA E SHTHURUR												GOJORE KRYEQYTETI I KANADASË					
"RIMINI"			ZANORE PERSIA E SOTME		TINGULLIM- ITIM PËREMËR VETOR										ENEIDA TARIFA ZANORE		
ZANORE		KRYEHOXHA MJET UDHËTIMI						ELBASAN		AKTORJA ... RINA MËSYMJA				AKTORJA BRI- TANIKE FRIEL			
EPOKA ERE	LLOJ LËNDË SHPËRTHYE- SE ORGANIZATË SEPARATISTE NË SPANJË							SËPATË E VOGËL QË KA TË BËJË ME LITE- RATURËN									
EPOKË (shq.)				SHUMË I MADH, GOXHA (turq.) ISMET MUNISHI								SHKRONJA XXXI KËNGËTARJA SHQIPTAR ERJON					
NGJYRA E LËKURËS SË FYTYRËS					ZANORE		VENDLINDJA E ODISEUT DASHUROR										
KRIJIM I NJË FILMI TË VIZA- TUAR (sh.shq.)									KASTRIOT OSMANI			LLOJ VETU- RE FRANCE- ZE					
2 					"EPOKA ..."				GODINA MBI LUMË FUTBOLLISTI SPANJOLL HELGUERA (shq.)								
					AKTORJA AMERIKANE SPELLING					PËREMËR PRONOR BABAI							
	EPOKA ERE	PJESA E EPËRME E DHOMËS FILM I REGJI- SORIT ISA QOSJA															
	KUSARI																
	RIFAT KUKAJ						NORA ISTREFI KËNGËTARJA NË FOTO 1				SËMUNDJE E RËNDË NGJITËSE UÇK (ang.)						
	ZANORE		DY ZANORE DRU GJETHOR I PYJEVE MALORE (shq.)					NJERINGRË- NËS AKTORJA HOLLIVUDIANE BASIGNER									
EPOKA ERE	PJESË E ILI- RISË (shq.)	LAKESË	PIKTURA KISHTARE	ALI TEPE- LENA	ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER ... ZAK				KEVIN LINDER JEVG			"G" në mes të dy "E"				EVERTON VEND LUFTIMI I GLADIATOR- ËVE	↓
KËNGËTARJA NË FOTO 2												PJESË E KËPUCËS (shq.) FILOZOFI GJERMAN IMANUEL					GURRË (sh.shq.)
ALEANCA FUTBOLLISTI KROAT KOVAÇ						UNITED OUTLOOK OBJECT MODEL NJËSI PËR MATJEN E FUQISË SË RRYMËS ELEKTRIKE					VEGËL MUZI- KORE SIGMA ALPHA EPSILON						
